

## **Agjencitë e (Pa) Varura dhe Ndërmarrjet “Publike” në Kosovë**

(Analizë mbi funksionimin e Agjencive të Pavarura dhe Ndërmarrjeve Publike, baza ligjore e tyre, politizimi i bordeve udhëheqëse, si dhe raportet e tyre me institucionet themeluese)



## **Përmbajtja:**

Hyrja .....	5
Metodologjia .....	6
Agjencitë e pavarura .....	7
Baza ligjore e themelimit dhe funksionimit të Agjencive të Pavarura në Kosovë.....	7
Institucionet e pavarura si kategori Kushtetuese .....	8
Agjencitë e pavarura të themeluara me ligje të veçanta .....	9
Pavarësia ligjore dhe praktika e funksionimit të tyre .....	10
Pavarësia Buxhetore .....	13
Mungesa e hapësirave fizike për punë .....	14
Raporti i Agjencive me institucionin themelues –Kuvendin e Kosovës .....	15
Organet udhëheqëse dhe politizimi i tyre .....	17
Anëtarët ndërkombëtarë në organet udhëheqëse .....	19
Kriteret për përcaktimin e nivelit të të ardhurave dhe mëditjeve .....	19
A ka nevojë Kosova për kaq shumë Agjenci? .....	21
Rekomandime .....	21

Ndërmarrjet Publike .....	23
Baza legale e themelimit dhe funksionimit të	
Ndërmarrjeve Publike në Kosovë .....	25
Bordet e Ndërmarrjeve Publike në Kosovë.....	27
Mënyra e funksionimit të tyre.....	28
Zgjedhja e organeve drejtuese.....	29
Politizimi mbi baza partiake.....	31
Kriteret për përcaktimin e nivelit të të ardhurave dhe mëditjeve .....	33
Raportimi për punën e Ndërmarrjeve Publike.....	35
Rekomandime .....	36

## Hyrje

Me konstituimin e institucioneve demokratike pas periudhës së vendosjes së administratës së UNMIK-ut në Kosovë, nëpërmjet rregulloreve të kësaj administrate, por edhe me ligje të veçanta, u vendosën bazat e themelimit dhe funksionalizimit të një numri të madh të Agjencive të Pavarura, të cilat rregullojnë dhe administrojnë çështje të caktuara dhe të rëndësishme.

Agjencitë dhe institucionet e pavarura janë entitete, të cilat shërbejnë për të rregulluar në mënyrë të pavarur funksione të ndryshme të jetës publike dhe ndahen në disa lloje. Formimi i disa institucioneve të pavarura, si: Auditori i Përgjithshëm, Avokati i Popullit apo Këshilli i Pavarur për Media, janë paraparë me Kushtetutën e Kosovës. Ndërkohë, Kushtetuta, gjithashtu lë hapësirë për formimin e agjencive të tjera sipas nevojës, nën autoritetin e Kuvendit të Kosovës apo Qeverisë. Këto agjenci dhe institucione formohen me ligje përkatëse, të cilat përfshijnë rregulloret e punës, organizimin, kompetencat, përzgjedhjen e bordeve apo drejtorëve, etj.

Institucionet e Kosovës, përkatësisht Kuvendi i Kosovës deri më tani kanë themeluar dhe funksionalizuar rreth 31 Agjenci të Pavarura, të cilat kanë obligim ligjor për raportim të drejtpërdrejtë në Kuvendin e Kosovës. Këto agjenci do të duhej të përfitonin nga një bazë e sigurt ligjore, ndërkohë që praktika tregon se dispozitat përkatëse jo gjithmonë zbatohen. Përveç kësaj, në disa raste mungon edhe legjislacioni sekondar.

Institucionet dhe Agjencitë e Pavarura, ende kanë paqartësi për mënyrën e financimit, ngase nuk ekziston një model unik i financimit të tyre. Disa sosh financohen direkt nga buxheti i Kosovës, ndërsa të tjerat mbështeten nga të ardhurat e veta burimore përmes tatimeve të ndryshme. Por, ka institucione, të cilat përfitojnë nga të dyja këto mundësi. Disa prej tyre marrin edhe ndihmë financiare nga donatorë ndërkombëtarë.

Roli i Kuvendit të Kosovës në mbikëqyrjen dhe kontrollin e këtyre institucioneve nuk është treguar mjaft efikas. Ai nuk ka zhvilluar kritere objektive për të vlerësuar punën e institucioneve të pavarura përmes raportimit të rregullt.

Ndërtimin e integritetit të Agjencive të Pavarura e pengojnë emërimet klienteliste politike në pozitat e larta udhëheqëse (në nivel bordi dhe ekzekutiv). Në shumë raste, emërimet e tilla i kanë shndërruar këto institucione në "çerdhe" për të rehabilituar militantët e subjekteve të caktuara politike.

Nga ana tjetër niveli i vetëdijesimit publik në lidhje me punën e institucioneve të pavarura është i dobët, sikurse edhe qasja në informata, e cila është e kufizuar. Deri tash nuk ka ekzistuar një presion i madh publik për të ndikuar në fuqizimin dhe depolitizimin e Agjencive të Pavarura si institucione të rëndësishme në Kosovë.

KDI, duke pas parasysh përvojën dhe ekspertizën e vet, përmes kësaj analize provon të jap kontributin qenësor në pasqyrimin objektiv të gjendjes aktuale me të cilën po ballafaqohen dhe po funksionojnë Agjencitë e Pavarura në Kosovë. Funksionalizimi dhe fuqizimi i tyre mbi parimet legale dhe profesionale, jo vetëm që do të ndihmojë rolin dhe angazhimin e tyre, por do të ndihmojë edhe në ndërtimin dhe fuqizimin e institucioneve demokratike në Kosovë.

## Metodologjia

Metodologjia e përdorur në realizimin e punimit është kryesisht kualitative. Fillimisht është bërë identifikimi dhe listimi i Agjencive të Pavarura që themelohen dhe i raportojnë Kuvendit, si dhe Ndërmarrjet Publike që operojnë në Kosovë. Më pastaj, është shqyrtuar baza kushtetuese dhe ligjore e institucioneve të përfshira në këtë studim si dhe raportet e tyre me Kuvendin e Kosovës.

Gjatë përpilimit të analizës janë konsultuar raportet vjetore të përgatitura nga këto institucione për Kuvendin e Kosovës, përkatësisht respektimi i afateve ligjore për raportim, përmbajtja dhe struktura e raporteve, si dhe qasja e Kuvendit të Kosovës (deputetëve) gjatë trajtimit të këtyre raporteve. Monitorimi i seancave të Kuvendit dhe mbledhjeve të komisioneve parlamentare, transkriptet dhe procesverbalet e këtyre mbledhjeve janë përdorë si burim i verifikimit të çështjeve të lartpërmendura. Në këtë aspekt gjithashtu janë shqyrtuar edhe hulumtime dhe raporte të ndryshme të organizatave vendore dhe ndërkombëtare mbi performancën e Agjencive të Pavarura dhe Ndërmarrjeve Publike në Kosovë.

Përbërja e bordeve të Agjencive të Pavarura, mënyra e funksionimit të tyre, politizimi i bordeve në baza klienteliste, kriteret për përcaktimin e nivelit të të ardhurave dhe mëditjeve po ashtu janë pjesë e trajtimit në këtë analizë. Për dokumentimin e dukurive është marrë për bazë edhe qasja në dokumente zyrtare, artikujt e besueshëm të mediave si dhe burime të tjera sekondare. Burime për analizën janë marrë edhe intervistat e drejtpërdrejta me akterë të ndryshëm relevant, si: deputetë të Kuvendit të Kosovës, përfaqësues dhe ish-përfaqësues të bordeve të agjencive dhe ndërmarrjeve publike, përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile, si dhe përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare në Kosovë.

## Agjencitë e pavarura

Institucionet dhe Agjencitë e Pavarura janë baza e një demokracie funksionale. Bashkë me pushtetet e tjera: legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, ato mundësojnë një sistem të zhvilluar të ruajtjes së baraspeshës, duke shtuar përgjegjshmërinë dhe duke zbutur ndikimin jo të drejtë politik. Sfidat me të cilat përballet demokracia e brishtë në Kosovë, vazhdojnë ta pengojnë zhvillimin e institucioneve duke u nisur që nga mungesa e vazhdueshme e resurseve, e në raste të caktuara deri tek ndërhyrjet politike.

Nocioni "institucione të pavarura", i referohet nevojës së institucioneve që të mbrohen nga çfarëdo lloj ndikimi, duke i bërë ato të pavarura dhe të rezistueshme ndaj ndërhyrjeve eventuale politike dhe duke u dhënë atyre autonomi vepruese. Sidoqoftë, njëjtë sikurse qeveria, edhe institucionet e pavarura i japin llogari përfaqësuesve të zgjedhur të Kosovës që e mbikëqyrin punën e tyre.

Standardet dhe praktikrat e vendeve të zhvilluara kanë përcaktuar disa kriteret apo kushte të cilat do të ndikojnë që Agjencitë e Pavarura ta ushtrojnë mandatin e tyre në mënyrë efikase dhe të lirë. Ndër kriteret primare, vlerësohet të jetë pavarësia financiare, e cila do të ndikonte në fuqizimin e autonomisë së plotë vepruese. Kriter tjetër i rëndësishëm vlerësohet të jetë pavarësia në emërimin e organeve drejtuese, e cila do të bazohej në vlera meritokracie dhe jo klienteliste e politike. Dhe e fundit, pavarësia në vendimmarrje dhe respektimi i vendimeve nga ana e institucioneve të tjera.

Institucionet e pavarura, pra janë subjekte kyçe të funksionimit të pushtetit, duke garantuar dhe siguruar kontrollin, ekuilibrimin si dhe zbatimin e sundimit të ligjit. Në përmbushjen e funksionit të tyre, në monitorimin e institucioneve, ato janë të pavarura, që do të thotë se puna e tyre nuk duhet të ndikohet politikisht apo të kontrollohet nga ndonjë organ i ekzekutivit.

## Baza ligjore e themelimit dhe e funksionimit të agjencive të pavarura

Agjencitë e Pavarura të Republikës së Kosovës janë institucione të pavarura të krijuara me Kushtetutë apo ligje të veçanta. Neni 142 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton formën dhe mënyrat e themelimit të Agjencive të Pavarura. Neni në fjalë përcakton katër parime bazë që duhet ta shoqërojnë themelimin dhe funksionimin e këtyre institucioneve.

Së pari, Kuvendi i Kosovës është autoriteti kushtetues i cili mban tagrin e themelimit të Agjencive të Pavarura. Për themelimin e tyre, kushtetuta përcakton se Kuvendi duhet të nxjerrë ligje përkatëse, që rregullojnë, ndër të tjera funksionimin dhe fushëveprimin ligjor të tyre. Së dyti Kushtetuta përcakton se Agjencive të Pavarura duhet t'u garantohet që ushtrimi i

funksionit të tyre ligjor të realizohet pa ndikim dhe në mënyrë të pavarur nga çdo udhëzim apo ndërhyrje e organeve të tjera shtetërore. Së treti, për garantimin e pavarësisë së tyre, përcaktohet se Agjencitë e Pavarura duhet të posedojnë buxhetin e tyre të veçantë, dhe të administrojnë me këtë të fundit në mënyrë të pavarur. Parimi i fundit kushtetues, i cili duhet të shoqërojë themelimin e Agjencive të Pavarura, lidhet me garancionin kushtetues që organet tjera shtetërore të bashkëpunojnë dhe t'u përgjigjen kërkesave të Agjencive të Pavarura gjatë ushtrimit të kompetencave ligjore<sup>1</sup>.

Për nga mandati dhe fushëveprimtaria e tyre, legjislacioni vendor ka përcaktuar dy lloje të institucioneve të pavarura që veprojnë në Kosovë. Në grupin e parë bëjnë pjesë ato institucione, të cilat kanë mandat mbikëqyrjen e qeverisë në respektimin e standardeve për qeverisjen e mirë në përgjithësi dhe që janë në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut. Kurse në grupin e dytë bëjnë pjesë institucionet e pavarura, të cilat kryejnë funksione rregullatore dhe licencuese. Përpos këtyre dy grupeve ekzistojnë edhe disa institucione që janë të karakterit kuazi-gjyqësorë, siç janë: Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës apo Komisioni i Pavarur për Media (KPM) .

E përbashkëta e të gjitha këtyre institucioneve është se ato janë të themeluara nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe për punën e tyre i raportojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë këtij institucioni në baza të rregullta vjetore, e disa nga to edhe në periudha tremujore.

## **Institucionet e pavarura si kategori Kushtetuese**

Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, është përfshirë një kapitull i veçantë (Kapitulli XII), në të cilën janë të listuara institucionet e pavarura, të cilat kanë epitetin si kategori kushtetuese. Në këtë kapitull janë përfshirë edhe dispozitat ku përcaktohet roli dhe përgjegjësitë e institucioneve të pavarura, mënyra e zgjedhjes së udhëheqjes dhe forma e raportimit të tyre tek institucionet themeluese. Në këtë kuptim, në kapitullin në fjalë renditen një numër i institucioneve qendrore, të cilat sipas përcaktimit kushtetues, duhet të funksionojnë dhe ushtrojnë kompetencat e dhëna në mënyrë të pavarur nga ndërhyrja ose ndikimi i organeve të tjera të Republikës së Kosovës. Po ashtu, ky kapitull vendos kufij të qartë që përcaktojnë formën e ushtrimit të autoritetit të organeve tjera shtetërore kundrejt fushëveprimit të organeve të pavarura, si dhe përcakton kriteret sipas së cilave Agjencitë e Pavarura mund të krijohen dhe të funksionojnë.

- Institucionet e pavarura si kategori kushtetuese të listuara në këtë kapitull janë:
- Avokati i Popullit
- Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

---

<sup>1</sup> Komentari – Kushtetuta e Republikës së Kosovës, botimi I, f.672. Autor Enver Hasani, Ivan Cukalovic. 2013



- Banka Qendrore e Kosovës dhe
- Komisioni i Pavarur i Mediave

Të gjitha këto institucione kanë fushëveprimtari tërësisht të ndryshme nga njëra tjetra, duke u nisur nga mbrojtja e të drejtave të njeriut, menaxhimi dhe ruajtja e stabilitetit financiar, kontrolli i shpenzimeve të fondeve publike, administrimi i proceseve zgjedhore e deri te rregullimi, menaxhimi dhe mbikëqyrja e spektrit të frekuencave të transmetimit në Republikën e Kosovës.

## **Agjencitë e pavarura të themeluara me ligje të veçanta**

Agjencitë e pavarura të Republikës së Kosovës janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Agjencitë e Pavarura funksionet e tyre i kryejnë në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës<sup>2</sup>.

Këto institucione të pavarura e kanë buxhetin e tyre, i cili administrohet në mënyrë të pavarur, në pajtim me ligj. Secili organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe t’u përgjigjet kërkesave të Agjencive të Pavarura gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore, në pajtim me ligjin<sup>3</sup>.

Kuvendi Kosovës që nga konstituimi i legjislaturës së parë ka miratuar një numër të madh të ligjeve, të cilat brenda tyre kanë përfshirë nevojën për themelimin e një agjencie specifike. Numri i Agjencive të Pavarura që janë themeluar nga ana e Kuvendit të Kosovës deri më tani ka arritur në 31. Këto agjenci për punën e tyre i përgjigjen dhe i raportojnë drejtpërdrejtë Kuvendit, përderisa veprojnë në distancë nga Kuvendi për të monitoruar dhe rregulluar në mënyrë të pavarur punën e degës ekzekutive të qeverisë.

Agjencitë e tilla janë:

1. Gjykata Kushtetuese
2. Autoriteti i Aviacionit Civil
3. Këshilli Gjyqësor
4. Komisioni i Pavarur Për Miniera dhe Minerale
5. Agjencioni Kosovar i Pronës (Bordi Mbikëqyrës, Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Sekretariati Ekzekutiv)

<sup>2</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës – neni 142 pika 1, gjendet në: <http://www.kushtetutakosoves.info/>

<sup>3</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës – neni 142 pika 3, gjendet në: <http://www.kushtetutakosoves.info/>

6. Agjencia Kundër Korrupsionit
7. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
8. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
- 9 Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
- 10 Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Kanalizim
- 11 Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
- 12 Instituti Gjyqësor i Kosovës
- 13 Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
- 14 Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës
- 15 Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
- 16 Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
- 17 Prokurori i Shtetit
- 18 Zyra Rregullative e Energjisë
- 19 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil
- 20 Fondi i Kursimeve Pensionale
- 21 Agjencia Kosovare e Privatizimit
- 22 Agjencia Kosovare e Intelegjencës
- 23 Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik
- 24 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
- 25 Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës
- 26 Radio Televizioni i Kosovës.

# PAVARËSIA LIGJORE DHE PRAKTIKA E FUNKSIONIMIT TË SAJ

Korniza ligjore të cilën e kanë miratuar institucionet e Kosovës, me qëllim të garantimit të pavarësisë së funksionimit të Agjencive të Pavarura, në masë të madhe arrin të garantojë pavarësinë funksionale të tyre. Megjithatë, përvoja jo edhe aq e gjatë e funksionimit të tyre ka dëshmuar në disa raste se ka konfuzitet në dispozita brenda ligjeve të caktuara, si dhe neglizhencë të institucioneve kompetente për plotësimin e kornizës ligjore të legjislationit sekondar. Kjo qasje ka penguar këto institucione që ta implementojnë mandatin e tyre ligjor dhe kushtetues.

Praktika e gjertanishme e punës së këtyre institucioneve ka treguar se nuk mjafton vetëm baza ligjore për të garantuar pavarësi në funksionalitet. Për këtë gjë nevojitet edhe vullneti për zbatimin e dispozitave ligjore dhe kushtetuese, në mënyrë që institucionet të jenë në shërbim të sendërtimit të shtetit ligjor.

Sfidat me të cilat po përballen këto institucione të pavarura janë të natyrave të ndryshme, si:

- harmonizimin e legjislationit me qëllim të qartësisë të përgjegjësisë dhe kompetencave mes institucioneve,

- politizimii i organeve udhëheqëse

- zarritja e qeverisë për t'í propozuar anëtarët e bordeve, të cilët më pas do të procedohen për miratim në Kuvend

- buxheti i pamjaftueshëm

- nevojat për rritjen e stafit

- mungesa e hapësirave fizike për punë, si dhe

- ikja e ekspertëve me përvojë në institucionet tjera

Nevoja për harmonizimin e legjislationit rrjedhë nga rrethanat apo rastet, ngase institucionet e vendit kanë krijuar agjenci, organet drejtuese të të cilave ndonëse i zgjedhë dhe i shkarkon Qeveria, duhet t'í raportojnë Kuvendit. Shembull i tillë është Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës<sup>4</sup>.

Sfida me të cilënpo ballafaqohen Agjencitë e Pavarura, është mungesa e anëtarëve në organet udhëheqëse të tyre. Kjo situatë është krijuar si rezultat i neglizhencës së Qeverisë së Kosovës që të propozojë anëtarët sipas kompetencave ligjore dhe kushtetuese. Vetëm gjatë kohës kur është draftuar kjo analizë, 10 agjenci janë me borde të pakompletuara, kurse 3 nga to nuk kanë borde fare, shkaku i skadimit të mandateve apo edhe imos konstituimit që nga koha e themelimit.

4 Neni 16.3 i Ligjit për Aviacioni Civil. Gjetet në [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L051\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L051_al.pdf)

Mos kompletimi i organeve udhëheqëse ka ndikuar që të ketë mungesë kuorumi për marrjen e vendimeve, gjë që i ka vënë pothuajse jashtë funksionit këto institucione.

Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP), që nga dorëheqja e kryesuesit të Bordit të Drejtorëve, z. Blerim Rexha dhe dy anëtarëve të tjerë të bordit, njëri nga të cilët ndërkombëtar, ka mbetur me bord jo të kompletuar. Mungesa e njërit drejtor ndërkombëtar e ka bërë të pamundur vendimmarrjen lidhur me pagesat, të cilat duhet të bëhen nga Fondi i mirëbesimit, të cilin e menaxhon kjo Agjenci. Ky proces ka mbetur peng, ngase me ligj kërkohet vota afirmative e të tre (3) anëtarëve ndërkombëtarë të bordit për çfarëdo vendimi.

Agjencioni tjetër, i cili është shumë i rëndësishëm në trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomik lidhur me proceset e tenderimit në Kosovë (Organi shqyrtues i Prokurimit Publik OSHP), që nga muaji korrik 2013 ka mbetur pa asnjë anëtarë bordi. Ky institucion ka funksionuar me bord të pa kompletuar qysh nga muaji maj i vitit 2010 ku z. Baki Krasniqi ka dhënë dorëheqje. Duhet theksuar se vetëm gjatë vitit 2013 ky institucion ka pranuar rreth 469 ankesa nga operatorët ekonomik, ndaj për mungesë të bordit udhëheqës, 214 ankesa ende kanë mbetur pa përgjigje.

Raste edhe më eklatant, përfaqëson Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor dhe Këshilli Kombëtar i Shkencës, të cilët kanë mbetur pa borde. Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor, që nga viti 2010 funksionon pa bord për shkak të skadimit të mandatit të anëtarëve të bordit. Të njëjtin fat e ka pasur edhe Këshilli Kombëtarë i Shkencës, i cili nuk ka asnjë anëtarë të zgjedhur. Sikurse edhe për shumicën e agjencive të tjera të pavarura, edhe Ligji Për Veprimtarinë Kërkimore – Shkencore, ka përcaktuar se shumica e propozimeve vijnë nga qeveria e Kosovës. Propozimi i Qeverisë me emrat e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës nuk është miratuar në Kuvendin e Kosovës, më 23.09.2012, ndaj që nga ajo kohë qeveria nuk i ka ofruar Kuvendit asnjë propozim tjetër.

Më mirë nuk qëndron as Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, i cili përkundër që ka në mandat një fushë të rëndësishme me qëllim të mbrojtjes së konkurrencës, ka në përbërjen e vet një anëtar bordi, nga pesë sa duhet t`i ketë. me ligj. Duhet theksuar se ky bord deri me 24 nëntor 2013 ka funksionuar me vetëm 3 anëtarë, sepse dy anëtarëve u ka skaduar mandati qysh me 24 nëntor 2011.

Së fundmi vështirësi në kryerjen e mandatitka edhe Komisioni i Pavarur për Media, i cili ka mbetur vetëm me 2 anëtarë, nga 6 sa duhet t`i ketë. Ky Komision fillimisht nuk ishte i plotë, meqë njëri anëtar (Emrush Kastrati), ka dhënë dorëheqje më 12 shtator 2013, kurse më pas Kuvendi, më 26 dhjetor 2013, pas rekomandimit të komisionit funksional parlamentar, shkarkoi nga pozita e anëtarëve të KPM-së: z. Shefki Ukaj- kryetar dhe Vesna Jovanović – anëtare<sup>5</sup>. I propozuar për shkarkim nga komisioni ishte edhe anëtari tjetër Nevzat Hydaverdi, i cili ndërroi jetë teksa ishte në detyrë.

Por, ka edhe agjenci të tjera, të cilat i kanë bordet e paplotësuara. Të tilla janë: Zyra e Rregullatorit për Energji (pa dy anëtarë të Bordit), Këshilli Gjyqësorë

5 Vendimi i Kuvendit. Gjendet në: <http://kpm-ks.org/materiale/dokument/1388153194.0154.pdf>

i Kosovës (pa dy anëtarë), Fondi Pensional i Kosovës (pa dy anëtarë), Bordi i Radio Televizionit të Kosovës RTK-së (pa 1 anëtar nga radhët e komunitetit serb) dhe Banka Qendrore e Kosovës (pa 1 anëtar).

Mos plotësimi apo jofunksionimi i disa bordeve të Agjencive të Pavarura ka ardhur si rezultat edhe i paqartësisë së legjislacionit që e normon këtë fushë në vendin tonë. Këtë mendim e ndan edhe Visar Ymeri – deputet i Kuvendit të Kosovës.

Sipas tij, në disa raste ka shpërputhje të legjislacionit, sepse këto institucione dhe pse konsiderohen si të pavarura, shumicën e anëtarëve të organeve udhëheqëse e propozon Qeveria, ndërkaq emërohen nga Kuvendi. “Meqë Kuvendi i ka themeluar dhe i mbikëqyrë këto institucione atëherë Kuvendi do të duhej t’i zgjedhte dhe emëronte anëtarët e bordeve të tyre. P.sh komisioni përzgjedhës të ishte gjithëpërfshirës (Kuvendi, Qeveria,SHC)<sup>6</sup>, ka sqaruar deputeti Ymeri.

Megjithëse ligji i aplikueshëm në vend, shpalljen e konkursit, intervistimin dhe përzgjedhjen e listës së ngushtë të kandidatëve për anëtar të bordeve ia ngarkon Qeverisë, komisioni parlamentar mund t’i dërgoj një shkresë Qeverisë së Kosovës, nga e cila kërkon fillimin e procedurave për përzgjedhjen e kandidatëve të ri për anëtar të bordeve. Ky komision, gjithashtu mund t’i ftoj zyrtarët qeveritar që të raportojnë në komision për përgatitjet e tyre për të menaxhuar procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të ri të bordit të një institucioni të pavarur. Megjithatë një praktikë e tillë do të ndikonte që komisionet parlamentare të ishin më të angazhuara në procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të bordeve dhe në të njëjtën kohë do të shmangeshin praktikat e tejkalimit të mandatit ose mos funksionimit të bordeve si pasojë e anëtarëve me mandat të skaduar. Por, fatkeqësisht praktika e tillë ndodh shumë rrallë në Kuvendin e Kosovës.

## **Pavarësia Buxhetore**

Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë përfshinë dispozita që garantojnë pavarësinë financiare të institucioneve duke u kujdesur që çdo kërkesë për buxhet të dorëzohet në tërësi në Kuvendin e Kosovës. Një numër i institucioneve mund të gëzojnë edhe financim plotësues në formë të mbledhjes së të hyrave apo fondeve nga donatorë ndërkombëtarë<sup>7</sup>.

Si themelues i institucioneve të pavarura, Kuvendi i Kosovës ka përgjegjësinë që këtyre institucioneve t’u sigurojë kushte për punë, si: hapësirat e punës, buxhetin dhe emërimin e anëtarëve në pozitat drejtuese. Vetëm Kuvendi i Kosovës është përgjegjës për buxhetin përfundimtar të institucioneve të pavarura. Gjatë procesit të buxhetimit për një agjenci të pavarur me të hyra të përcaktuara, as ministritë dhe as Qeveria nuk janë të autorizuara që të bëjnë ndryshimin e propozim-buxhetit ose kërkesës për ndarje buxhetore të një agjencie të pavarur ose gjykatave. Kjo në rastin kur ky dokument është dorëzuar deri në datën e përcaktuar në qarkoren buxhetore dhe në përputhje me formën e kërkuar në qarkore. Nëse dokumenti nuk i është dorëzuar

<sup>6</sup> Visar Ymeri – shef i grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje. Intervistë personale,

Ministrisë së Financave deri në datën e përcaktuar, ministri është i autorizuar që të përgatisë propozim-buxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore për agjencinë përkatëse të pavarur. Kjo kërkesë nuk duhet të jetë më e madhe se buxheti dhe kërkesa për ndarje buxhetore për vitin aktual fiskal<sup>7</sup>.

Baza aktuale ligjore garanton një pavarësi të theksuar, për atë që mund të aplikohet këtu dhe për shkakun se vetë emërimi apo përzgjedhja e anëtarëve të bordit bëhet me votim në Kuvend<sup>8</sup>.

Megjithatë, disa nga përfaqësuesit e institucioneve të pavarura që janë përfshirë në këtë analizë kanë shprehur shqetësimet e tyre sa i përket mjaftueshmërisë së buxheteve të ndara për të ushtruar në tërësi mandatin e tyre. Veçanërisht, buxheti i cili aprovohet nga Kuvendi shpesh është më i mangët për dallim nga kërkesa fillestare. Shqetësimin e tillë e shpreh edhe përfaqësuesi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, i cili vlerëson se shpeshherë nuk janë të kënaqur meqë nuk aprovohet buxheti ashtu siç i paraqesin kërkesat.<sup>9</sup>

Duke e ditur se pa pavarësi financiare nuk mund të flitet për pavarësi të një agjencie të caktuar, deputeti Visar Ymeri, vlerëson se ajo është garant edhe i pavarësisë funksionale të Agjencive të Pavarura në vendin tonë. Megjithatë, sipas tij, disa nga agjencionet e kanë keqpërdorur pavarësinë financiare, sepse më shumë e kanë orientuar buxhetin e tyre për përfitime personale të anëtarëve të bordeve dhe stafit se sa për zhvillimin e Agjencisë. Secila pagë që merret nga paratë publike duhet të jetë publike dhe jo e fshehur nga opinioni. "Pavarësisht autonomisë financiare duhet të ekzistojë një kufi për pagat më të larta dhe më të ulëta, gjë e cila lidhet me zhvillimin ekonomik të vendit",<sup>10</sup> shton më tej z. Ymeri.

## Mungesa e hapësirave fizike për punë

Megjithëse janë krijuar prej disa vjetësh, disa Agjenci të Pavarura përballen me mungesë të hapësirës për punë. Ndonëse lidhshimi institucional ka premtuar zgjidhjen e kësaj çështje, mungesa e hapësirës për punë, ende mbetet problem i pazgjidhur.

Institucioni Avokatit të Popullit (IAP), Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), Komisioni i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil (KPMSHC), Këshilli për Trashëgimi Kulturor, Zyra e Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim dhe Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, janë disa nga agjencitë të cilat ende janë të vendosura në objekte të përkohshme dhe me hapësira fizike të pamjaftueshme, e cila gjë po pengon në zbatimin e mandatit ligjor dhe kushtetues të tyre.

7 Neni 66, pika 1 e Ligjit nr.03/L-048. Gjetet në [http://www.gazetazyrtare.com/e/gov/index.php?option=com\\_content&task=view&id=141&Itemid=56](http://www.gazetazyrtare.com/e/gov/index.php?option=com_content&task=view&id=141&Itemid=56)

8 Agron Krasniqi – Zv.drejtor i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës. Intervistë personale.

9 Bajram Ajeti - Kryetarë i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Intervistë personale

10 Visar Ymeri – shef i grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje. Intervistë personale.

# RAPORTI I AGJENCIVE ME INSTITUCIONIN

## THEMELUES – KUVENDIN E KOSOVËS

Kuvendi i Kosovës përveç që themelon, aprovon buxhetin dhe bën përzgjedhjen e anëtarëve në pozitën udhëheqëse të institucioneve të pavarura, gjithashtu mbikëqyrë punën e tyre. Institucionet e pavarura janë të obliguara që të raportojnë para Kuvendit në bazë vjetore. Kuvendi e ka të drejtën të kërkojë raporte të jashtëzakonshme nga çdo institucion i pavarur i themeluar nga ai.

Afatet e dorëzimit të raporteve vjetore ndryshojnë nga institucioni në institucion dhe janë të përcaktuara me ligjet përkatëse. Por, zakonisht, institucionet e pavarura janë të obliguara që ta dorëzojnë raportin vjetor të punës më së largu deri më 31 mars të vitit vijues fiskal. Të gjitha institucionet kanë së paku tre muaj kohë, nga data e përfundimit të vitit, që t`i përgatisin raportet e tyre vjetore. Përmbajtja e raporteve dallon në bazë të fushëveprimtarisë së institucionit. Nuk ekziston ligj apo akt nënligjor i veçantë, i cili përcakton rregullat e hartimit të raporteve vjetore. Disa ligje përcaktojnë edhe përmbajtjen bazë të raportit, të cilin institucioni është i obliguar që ta dorëzojë në Kuvend .

Legjislacioni i aplikueshëm në Kosovë, i obligon të gjitha institucionet e pavarura, të cilat janë themeluar nga Kuvendi t`i raportojnë drejtpërdrejtë atij institucioni. Këto institucione për çdo vit kalendarik ia dorëzojnë komisionit përkatës të Kuvendit raportin vjetor të punës së tyre. Si i tillë, ky raport është dokument publik. Pasi komisioni funksional ta trajtojë atë, ai bashkë me rekomandimet e komisionit i procedohet për miratim seancës plenare të Kuvendit. Kuvendi me shumicë të votave vendos për miratimin apo mosmiratimin e tij.

Anëtarët e Kuvendit në raste të caktuara japin komente dhe rekomandime në lidhje me raportet e dorëzuara, mirëpo institucionet e pavarura rrallë mbajnë përgjegjësi për implementimin e rekomandimeve në periudhën e ardhshme raportuese. Në fakt, rekomandimet nuk regjistrohen në mënyrë sistematike, gjë e cila e bën përcjelljen e implementimit të tyre të vështirë ose edhe të pamundur. Praktika e gjertanishme ka treguar disa raste kur Kuvendi i Kosovës nuk i ka miratuar raportet vjetore të institucioneve të pavarura, siç ka qenë rasti me raportet vjetore të dorëzuara nga AKP-ja (Agjencioni Kosovar i Privatizimit) dhe RTK-ja në vitin 2013. Këtu ekziston një zbrastësi ligjore, sepse nuk ka një obligim formal sa i përket ridorëzimit të raporteve apo sanksione ndaj organeve udhëheqëse të institucioneve që u janë refuzuar raportet. Kjo qasje në pikëpyetje rolin mbikëqyrës të Kuvendit të Kosovës në raport me institucionet e pavarura.

Rolin jo shumë efikas të Kuvendit të Kosovës në raport me këto institucione e ka adresuar edhe Komisioni Evropian përmes Raportit të Progresit për Kosovën. Në Raportin e fundit të këtij institucioni të publikuar në vitin 2013 thuhet se: "Kuvendi ka nevojë për të përmirësuar rolin e tij në mbikëqyrjen e institucioneve të pavarura dhe autoritetet rregullatore. Në këtë drejtim,

duhet ngritur mekanizmat adekuate<sup>11</sup>". Gjithashtu ky institucion ka adresuar edhe çështje tjera në kontekstin e funksionimit të këtyre institucioneve. "Bazat e paqarta ligjore për raportim, koordinim të dobët me qeverinë në përzgjedhjen e anëtarëve të bordeve dhe dështimi për të përcaktuar mekanizma për mbajtjen e anëtarëve të bordit në llogari janë ndër sfidat kryesore të cilat duhet të adresohen. Kjo do të ndihmojë për të siguruar në kohë emërimin e menaxherëve të pavarur dhe profesional dhe anëtarëve të bordeve të këtyre institucioneve"<sup>12</sup> thuhet më tej në këtë Raport.

Me qëllim që kjo çështje të përmirësohet, nevojitet me ligj të sanksionohen agjencitë, raportet e të cilave nuk miratohen nga ana e Kuvendit të Kosovës. Duhet të ekzistoj një lidhshmëri ndërmjet Kuvendit dhe Agjencive të pavarura, në mënyrë që të kemi një vlerësim të vazhdueshëm të punës së tyre dhe jo të pritët vetëm njëherë në vit që t`i sjellin raportet në Kuvend.

Problem tjetër i identifikuar në raportet ndërmjet Kuvendit dhe Agjencive të Pavarura është edhe forma e raportimit. Mungesa e një rregulli për mënyrën e raportimit për të gjitha Agjencitë e Pavarura, ku do të vendoseshin disa kritere të pranueshmërisë së raporteve nga ana e administratës së Kuvendit, ka bërë që shpeshherë raportet të përdoren për të fshehur të vërtetën në vend të objektivitetit.

Gjithashtu, problem tjetër, paraqet edhe koha kur trajtohen këto raporte nga ana e Kuvendit të Kosovës. Shqyrtimi i raporteve financiare para se të bëhet publik raporti i Auditorit të Përgjithshëm, shpeshherë vë në lajthitje Kuvendin duke miratuar raporte, në të cilat më pas nga Zyra e Auditorit janë identifikuar disa parregullsi. Për këtë shkak, Kuvendi duhet të rishikoj afatet, me qëllim që raporti financiar i një institucioni të caktuar të shqyrtohet dhe aprovohet pasi të jetë bërë publik Raporti i Auditorit të Përgjithshëm.

Në raportet reciproke ndërmjet Kuvendit dhe agjencive nuk paraqiten të meta vetëm tek Agjencitë e Pavarura, por edhe te vetë Kuvendi. Jo rrallë, deputetët e Kuvendit apo edhe ministrat kompetent nuk i lexojnë fare apo i neglizhojnë në masë të madhe raportet që prezantohen nga agjencitë. Këtë shqetësim e ka shfaqur edhe Sami Kurteshi, Avokat i Popullit.

"Në Kuvend shpeshherë nuk janë të pranishëm përgjegjësit e institucioneve për të cilët bëhet raporti-Qeveria. Por, në të shumtën e rasteve ka ngjarë që kryeministri të dërgojë ministra të caktuar për sulm, por Kuvendi në të vërtetë nuk ka pasur dijeni për raportin, por ka diskutuar për raportin dhe në fund është votuar. Pra Kuvendi është shndërruar në një makinë votimi edhe rutina e votimit e mund arsyen politike për atë që ekziston Kuvendi<sup>13</sup>, thotë Kurteshi.

---

11 Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2013, f. 7 , gjendet në [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2013/package/ks\\_rapport\\_2013.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/ks_rapport_2013.pdf)

12 Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2013, f. 7 , gjendet në [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2013/package/ks\\_rapport\\_2013.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/ks_rapport_2013.pdf)

13 Sami Kurteshi – Avokat i Popullit. Intervistë personale



Kuvendi me qëllim të mbikëqyrjes efikase duhet të ndërtoj mekanizma që në mënyrë të vazhdueshme do t'i mbante nën llupë këto institucione. Një shembull të tillë e ka ndërtuar shteti fqinj Shqipëria, e cila në kuadër të Kuvendit ka krijuar një departament të veçantë për monitorim dhe shërbim të Agjencive të Pavarura. Ky departament në vazhdimësi ofron raporte për punën apo mospunën e këtyre institucioneve dhe informatat e tilla i shërbejnë Kuvendit, Kryesisë dhe Komisioneve parlamentare. Varësisht nga përmbajtja e raporteve, Kuvendi vendos edhe për kohën si dhe formën e shqyrtimit e reagimit.

## ORGANET UDHËHEQËSE DHE POLITIZIMI I TYRE

Ndër sfidat më të mëdha me të cilat po përballlet Kuvendi në raport me institucionet e pavarura është moskoordinimi me Qeverinë për të zgjedhur me kohë anëtarët e bordeve, propozimet mbi baza politike dhe klienteliste si dhe mospërcaktimi i mënyrës së mbajtjes në përgjegjësi të anëtarëve të bordeve. Edhe pse institucionet e pavarura janë përgjegjëse vetëm para Kuvendit të Kosovës, Qeveria e Kosovës bënë përzgjedhjen e kandidatëve, kurse Kuvendi përzgjedh në mesin e kandidatëve të propozuar nga Qeveria.

Kuvendi i Kosovës, përmes komisioneve funksionale e ka të drejtën e emërimit të zyrtarëve në pozitat e larta drejtuese në institucionet e pavarura. Procedurat për përzgjedhjen e zyrtarëve drejtues në institucionet e pavarura janë të ndryshme. Rregullat e selektimit dhe emërimit të zyrtarëve udhëheqës të këtyre institucioneve përcaktohen me ligjin, i cili themelon institucionin e pavarur. Por, në përgjithësi, ekzistojnë dy mënyra të përzgjedhjes së drejtuesve të institucioneve të pavarura:

1. Qeveria shpall konkurs për plotësimin e pozitave udhëheqëse në institucionin e pavarur, udhëheq procesin e selektimit dhe intervistimit, emrat e kandidatëve më të mirë i dërgohen Kuvendit për aprovim përfundimtar,
2. Vetë Kuvendi i ndërmerr të gjitha procedurat e nevojshme: shpalljen e konkursit, intervistimin, përzgjedhjen<sup>14</sup>.

Në të shumtën e rasteve praktika e këtillë e përzgjedhjes së anëtarëve të bordeve ka krijuar polemika. Deputetë të partive parlamentare janë ankuar se nga kjo praktikë shpesh detyrohen të përzgjedhin ndërmjet kandidatëve politik në njërën anë dhe atyre të pakualifikuar nga ana tjetër.

Dihet mirëfilli se Kosova ka një mungesë të traditës së funksionimit dhe strukturimit të Agjencive të Pavarura, dhe kjo e bën të dukshëm ndikimin e politikës. Politizimi i bordeve të këtyre institucioneve duke i shndërruar në çerdhe të akomodimit të anëtarëve dhe militantëve partiak me theks të veçantë partive në pushtet, ka ndikuar që këto institucione të mos jenë të pavarura në ushtrimin e mandatit të tyre kushtetues.

<sup>14</sup> Doracak - Funkzioni Mbikëqyrës i Komisioneve parlamentare, f. 41. Botuar nga Kuvendi i Kosovës në qershor 2012

Rast i tillë është emërimi i Bedri Hamzës në krye të BQK-së. Në këtë post, Hamza erdhi nga ai i ministrit të financave dhe anëtarit të Kryesisë së PDK-së. Me qëllim që të plotësonte aspektin formal ligjor, ai kishte dhënë dorëheqje nga postet publike disa ditë para se të kandidohej për postin e Guvernatorit. Rast i njëjtë është edhe ai me emërimin e Blerim Rexhës, kryesues i Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Ai dha dorëheqje pas disa muajsh bashkë me dy anëtarë të tjerë, duke përfshirë edhe përfaqësuesen amerikane, Bernadette Roberts.

Rexha disa ditë para se të zgjidhej në krye të AKP-së, ishte anëtar i Këshillit të përgjithshëm të PDK-së.

I treti rast i kësaj natyre është ai i emërimit të Ruzhdi Jasharit në krye të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Jashari për disa vjet radhazi ka shërbyer si këshilltar i PDK-së në Kuvendin Komunal në Shtime.

Në udhëheqjen e Bordit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, nga viti 2009 është z. Ruzhdi Morina, ish- kryetar i Forumit Rinor të PDK-së. Në të njëjtën kohë deri në gusht të 2012, Morina ka ushtruar edhe funksionin e kryeshefit ekzekutiv të ndërmarrjes publike "Trainkos", por pas inicimit të hetimeve për konflikt interesi nga ana e Agjencisë Kundër Korrupsion, ai është dorëhequr nga kjo pozitë.

Së fundmi Kuvendi i Kosovës shkarkoi nga funksioni i kryesuesit të Bordit të KPM, Shefki Ukajn, me pretekstin se ka fshehur në CV e tij, angazhimin si këshilltar në komunën e Prishtinës nga radhët e LDK-së.

Kjo praktikë po dëshmon se politika po mbanë të uzurpuara institucionet epavarura. Kësisoj, jo rrallë në Kuvendin e Kosovës sillen emrat e njëjtë të propozuar nga qeveria, ndonëse të refuzuar prapakisht nga ana e deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Një qasje e tillë ka dëshmuar për tendencat e vazhdueshme të politikës për t' i shfrytëzuar këto institucione si vende për punësimin dhe rehabilitimin e militantëve dhe eksponentëve politik. Politizimi dhe partizimi i institucioneve të pavarura mbi baza klienteliste, ka cenuar funksionalitetin e shtetit të së drejtës dhe ndërtimin e një demokracie funksionale.

Emërimet e pozitive të larta (në nivel bordi dhe ekzekutiv) vonohen. Vendet e lira të punës mbeten të hapura për periudha të gjatë kohore duke penguar seriozisht funksionimin e institucioneve përkatëse<sup>15</sup>.

## **Anëtarët ndërkombëtarë në organet udhëheqëse**

Që nga koha e administrimit ndërkombëtarë të Kosovës, por edhe më vonë me Pakon gjithëpërfshirëse të Presidentit Ahtisari, disa nga Agjencitë e Pavarura në organet e tyre udhëheqëse kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë anëtarë ndërkombëtarë. Të tillë janë: Gjykata Kushtetuese, Agjencioni Kosovar i Privatizimit, Auditori Gjeneral, Agjencia Kosovare e Pronës dhe

15 Gjendja e institucioneve të pavarura në Kosovë – botuar nga OSBE në Kosovë, korrik 2012, f.4. Gjendet në <http://www.osce.org/sq/kosovo/92052?download=true>

Fondi i Kursimeve Pensionale. Sipas Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, të miratuar në shtator 2012, k 31 gushti 2014 është përcaktuar koha kur ju përfundon mandati shumicës së përfaqësuesve ndërkombëtar në bordet udhëheqëse të institucioneve të pavarura. Nisur nga ndjeshmëria e institucioneve, mbetet sfidë që ata të zëvendësohen me kuadro që do të ruajnë pavarësinë institucionale dhe profesionalizmin.

## KRITERET PËR PËRCAKTMIN E NIVELIT TË TË ARDHURAVE DHE MËDITJEVE

Legjislacioni i aplikueshëm në vend ende nuk e ka ndërtuar një model unik të financimit për institucionet e pavarura në Kosovë. Kjo ka bërë që të ketë dallime enorme të të ardhurave nëpër agjenci të ndryshme., pavarësisht statusit të njëjtë ligjor. Shumica prej tyre financohen nga buxheti i Kosovës, i cili miratohet çdo vit nga Kuvendi. Vetëm një numër i vogël i tyre ka mandatin e mbledhjes së të hyrave të përcaktuara nga taksat për licencim apo taksat speciale. Kurse një pjesë të agjencive ju lejohet t'i mbajnë krejtësisht apo pjesërisht një pjesë të tarifave të mbledhura si të hyra operative.

Mungesa e një ligji i cili standardizon nivelin e pagave ka bërë që të ekzistojnë nivele të ndryshme pagash në institucionet e pavarura. Disa nga bordet paguhen me honorar, në bazë të numrit të takimeve në të cilat marrin pjesë, të tjerët paguhen me pagë fikse. Në ato raste kur paga është fikse, referencat janë të ndryshme dhe dallojnë shumë nga agjencia në agjenci. P.Sh. me Ligjin për Avokatin e Popullit ishte përcaktuar që niveli i pagës së Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij caktohet në pajtim me "Ligjin për Pagat e zyrtarëve të Lartë Publik", ligj i cili ende nuk është miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Të njëjten formë me ligj e ka të përcaktuar edhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Në nenin 21 të tij, thuhet se: "niveli i pagës së kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit caktohet në pajtim me ligjin për pagat e zyrtarëve të lartë"<sup>16</sup>.

Disa institucione e kanë rregulluar këtë çështje me akte të brendshme, rregullore dhe udhëzime administrative. Një i tillë është Trusti Pensional i Kosovës. Sipas Agron Krasniqit, zëvendësdrejtor i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, ky institucion ka adoptuar rregulloret dhe udhëzimet sa i përket mëditjeve dhe udhëtimit. "Pjesa e mëditjeve dhe e të ardhurave për stafin mbetet në kompetencë të bordit drejtues, i cili i merr këto vendime. I kemi skemat e brendshme që caktojnë shumën, por duhet ta dimë që jo veç Fondi Pensional, por të gjitha institucionet tjera të pavarura janë në

16 Neni 21, Ligji nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Gjetet në <http://kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-192-alb.pdf>

konkurrencë direkte me industrinë në të cilën operojnë<sup>17</sup>, ka sqaruar Krasniqi.

Kurse nga ana tjetër, disa agjenci të tjera pagën e udhëheqësve e kanë përcaktuar si ekuivalente apo referente me pagën e një posti dhe institucioni tjetër edhe pse kjo nuk ka fare të bëjë me statusin e Agjencive të Pavarura. Shembull i tillë është paga e Drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, e cila ka për referencë pagën e një kryesuesi të komisionit parlamentar<sup>18</sup>. Apo rasti tjetër, ku të ardhurat e anëtarëve të Bordit dhe Drejtorit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) përcaktohen nga Komisioni i Kuvendit për Buxhet dhe Financa<sup>19</sup>.

Është imperativ i kohës që të miratohen norma që standardizojnë pagat në të gjitha Agjencitë e Pavarura. Gjithashtu duhet mënjanuar edhe shpërputhjen e pagave ndërmjet agjencive të caktuara. Në disa sosh pagat nëpër agjenci të pavarura i kalojnë për shumëfish pagat e zyrtarëve më të lartë shtetëror.

---

17 Agron Krasniqi - Zëvendësdrejtor i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës. Intervistë personale.

18 Neni 9, Ligji nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit, 5 shkurt, 2010. Gjetet në: [http://akk-ks.org/repository/docs/Ligji\\_per\\_Agjencine\\_kunder\\_Korrupsionit\\_nr\\_03\\_L\\_159.pdf](http://akk-ks.org/repository/docs/Ligji_per_Agjencine_kunder_Korrupsionit_nr_03_L_159.pdf)

19 Neni 64, Ligji nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, 27 gusht, 2010. Gjetet në: [http://www.kosovo-mining.org/kosovoweb/al/downloads/legislation/basicContentParagraphs/00/document/Ligji%20per%20Minierat%20dhe%20Mineralet%20\(shqip\).pdf](http://www.kosovo-mining.org/kosovoweb/al/downloads/legislation/basicContentParagraphs/00/document/Ligji%20per%20Minierat%20dhe%20Mineralet%20(shqip).pdf)

## A KA NEVOJË KOSOVA PËR KAQ SHUMË AGJENCI TË PAVARURA?

Tradita jo e begatë e jetës demokratike dhe institucionale në Kosovë, ka bërë që të mos kuptohet qartë roli dhe rëndësia që kanë Agjencitë e Pavarura, në rregullimin e disa segmenteve të rëndësishme shtetërore. Kjo mungesë e traditës ka ndikuar që të themelohen një numër enorm i rreth 36 institucioneve të pavarura pa pasur ndonjë analizë të detajuar për nevojën e themelimit të tyre. Aktivisti i shoqërisë civile Avni Zogiani vlerëson se shumë nga agjencitë janë krijuar sa për të përmbushur kërkesën e faktiorit ndërkombëtar, , pa reflektuar nevojat tona dhe specifikat tona<sup>20</sup>. Situata e tillë mund të ketë ardhur edhe nga tendencat për krijimin e institucioneve me qëllim të punësimit të njerëzve mbi baza nepotiste dhe politike. Edhe Avokati i Popullit Sami Kurteshi e lë të hapur mundësinë që shumë agjenci të pavarura janë krijuar me qëllim të punësimit të njerëzve të afërt. Sa i përket funksionalitetit, ai mendon se Kosova ka tepër agjenci. “E nevojë reale, as përfaqësisht nuk kemi sa duhet të ketë, sepse ne krijojmë institucione për qëllime tjera, por jo për nevoja reale<sup>21</sup>, ka thënë më tej z. Kurteshi.

Ushtrimi i funksioneve dhe aktiviteteve që aktualisht i kryejnë kaq shumë agjenci, mund të kryhen nga degët e tjera të pushteteve pa e pasur statusin e agjencive. Fuzionimi i disa prej tyre mund të ishte zgjidhja më e mirë në sistemin e funksionimit të këtyre institucioneve. Mendim të tillë ka edhe deputeti Visar Ymeri, i cili vlerëson se nuk ka nevojë për kaq shumë agjenci. “Disa prej tyre mund të bashkohen me një agjenci të vetme. Gjithashtu duhet të kemi një mekanizëm koordinues të politikave të tyre për shkak të ndërlidhjes mes politikave<sup>22</sup>”, mendon z. Ymeri.

Përkundër vlerësimeve të shumë të intervistuarve në këtë analizë se vendi ynë nuk ka nevojë për një numër kaq të madh të Agjencive të Pavarura, paradoksi i krijimit të agjencive të reja vazhdon. Kësisoj, Kuvendi i Kosovës më 19.03.2013 themeloi edhe Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.

20 Avni Zogiani, Drejtor Ekzekutiv në Organizatën “Qohu”. Intervistë personale,

21 Sami Kurteshi – Avokat i Popullit. Intervistë personale.

22 Visar Ymeri – shef i grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje. Intervistë personale.

## Rekomandime

- Kuvendi i Kosovës duhet të analizojë dhe rishqyrtoj numrin e Agjencive të Pavarura të themeluarasi dhe ta shohë mundësinë për fuzionimin apo zvogëlimin e tyre;
- Kuvendi ta standardizojë legjislacionin, i cili rregullon formën e financimit (të ardhurat dhe mëditjet), formën e raportimit dhe përzgjedhjes së anëtarëve të organeve udhëheqëse të Agjencive të Pavarura;
- Kuvendi ta përfshijë në Rregullore të punës sanksionimin për mosraportim dhe mosmiratim të raportit të një Agjencie të caktuar;
- Kuvendi të ndërtoj mekanizma për monitorimin dhe komunikimin e vazhdueshëm me agjencitë, për ta përcjellë punën e tyre dhe implementimin e rekomandimeve që dalin nga seanca plenare në ato raste kur raporti i tyre miratohet;
- Të krijohet një mekanizëm koordinues i politikave të Agjencive të Pavarura, për shkak të ndërlidhjes mes politikave;
- Komisionet parlamentare ti shqyrtojnë me kujdes nevojat e Agjencive të Pavarura gjatë procesit të buxhetit për t'u kujdesur që ata të kenë resurse dhe hapësira fizike të mjaftueshme për të ushtruar mandatin;
- Kuvendi duhet t'i rishikoj afatet e shqyrtimit të raporteve financiare të agjencive. Raporti financiar i institucionit duhet shqyrtuar dhe aprovuar pasi të jetë bërë publik raporti i Auditorit të Përgjithshëm, (në disa raste, komisioni parlamentar ka aprovuar pa vërejte raportin financiar, kurse raporti i auditimit ka gjetur parregullsi në menaxhimin e buxhetit);
- Qeveria e Kosovës t'i nominoj krerët ose anëtarët e bordit të institucioneve të pavarura, me kohë sipas dispozitave të përcaktuara me ligj;
- Me qëllim të depolitizimit të organeve udhëheqëse të agjencive, Komisionet parlamentare dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile duhet të përfshihen qysh në fazat fillestare të intervistimit të kandidatëve që propozohen nga qeveria për të udhëhequr agjencitë e caktuara;
- Kuvendi dhe Qeveria duhet fillojnë me procedurat e identifikimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve, për t'i zëvendësuar anëtarët ndërkombëtarë, të cilëve u përfundon mandati si anëtarë të bordeve më 31 gusht 2014;
- Të azhurnohen uebfaqet e agjencive të pavarura me qëllim të informimit të rregullt të qytetarëve me zhvillimet në lidhje me punën e institucionit, si dhe plasimit të komunikatave të rregullta për shtyp;
- Të përdoren mediat për informimin e qytetarëve për rolin dhe funksionin që kryejnë këto institucione.

## NDËRMARRJET PUBLIKE

Që nga viti 1999 Ndërmarrjet Publike (NP) në Kosovë, kanë qenë nën mbikëqyrje të administratës ndërkombëtare të instaluar në Kosovë- UNMIK-ut. Ndërkaq me themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, në qershor 2002, ato u vendosën nën menaxhimin e saj. AKM-ja ka korporatizuar të gjitha NP-të (gjithsej 25), që i kishte në portfolio. Më pas krijoi një strukturë të re të qeverisjes korporatave, duke themeluar Bordet e Drejtorëve si organe më të larta vendimmarrëse në të gjitha NP-të. Pas përfundimit të mandatit të AKM-së, e cila më pas u transformua në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), shumica e anëtarëve të emëruar nga AKM-ja janë dorëhequr, por më pas vendet e lira janë plotësuar me emërimet nga Qeveria e Kosovës. Procesi i korporatizimit ka paraparë kthimin e këtyre kompanive në shoqëri aksionare, ku pronar i vetëm apo kryesor është publiku nëpërmjet Qeverisë të Kosovës. Me anë të këtij korporatizimi, Qeveria e Kosovës ka siguruar pronësinë e saj ligjore mbi NP-të, duke lënë hapësirë për tërheqjen e investimeve nëpërmjet shitjes së aksioneve.

Ndërmarrjet në pronësi publike në Kosovë ofrojnë shërbime të furnizimit me energji elektrike, shërbime telekomunikimi, shërbime të transportit hekurudhor, shërbime të kontrollit ajror, si dhe shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimeve, kryesisht në nivel komunal. Kompanitë energjetike dhe telekomunikuese janë punëdhënësit më të mëdhenj në Kosovë, ku vetëm KEK sh.a. punëson rreth 5.000 punëtorë. Këto kompani kanë ndikim të fuqishëm në funksionimin e sektorëve të tjerë të ekonomisë, si ofrues të inputeve kyçe. Ato, gjithashtu ndikojnë në mirëqenien e qytetarëve në mënyrë të drejtpërdrejtë. Çfarëdo qoftë përmirësimi në performansën e tyre, do të ketë efekt të drejtpërdrejt dhe të fortë në ekonomi dhe në shoqëri<sup>23</sup>.

Për nga funksioni dhe mandati që kanë, Ndërmarrjet Publike në Kosovë janë të ndara në: Ndërmarrjet Publike Qendrore (NPQ), të cilat Qeveria mund t'i privatizojë, japë me koncesion ose me qira, dhe Ndërmarrjet Publike Lokale (NPL), ku pronarë janë komunat, përcaktuar sipas Ligjit 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/l-087 për ndërmarrjet publike.

### 1. Ndërmarrjet Publike Qendrore

1. Korporata Elektro-energjetike e Kosovës Sh.A (KEK);
2. Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut, Sh.A (KOSTT);
3. Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A (PTK)
4. Trainkos;

23 Qeverisja korporative 1, f.46. Botim i Institutit Riinvest nëntor 2006. Gjetet në: <http://www.riinvestinstitute.org/publikimet/pdf/22.pdf>

5. Infrakos;
6. Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës Sh.A;
7. Kompania për Menaxhimin e Deponive Sh.A;
8. NPH "Ibër Lepenc" Sh.A;
9. Radio Televizioni i Kosovës (RTK).

#### Kompanitë Rajonale të Ujitjes

1. Kompania e Ujitjes "Drini i Bardhë" Sh.A.
2. Kompania e Ujitjes "Radoniqi-Dukagjini" Sh.A

#### **Kompanitë Rajonale të Ujësjes**

1. Kompania Rajonale e Ujësjes "Prishtina" Sh.A, Prishtinë
2. Kompania Rajonale e Ujësjes "Hidrodrini" Sh.A, Pejë
3. Kompania Rajonale e Ujësjes "Hidroregjioni Jugor" Sh.A, Prizren
4. Kompania Rajonale e Ujësjes "Mitrovica" Sh.A, Mitrovicë
5. Kompania Rajonale e Ujësjes "Hidromorava" Sh.A, Gjilan
6. Kompania Rajonale e Ujësjes "Radoniqi" Sh.A, Gjakovë

#### **2. Ndërmarrjet Publike Lokale**

1. Ngrohtorja e Qytetit "Termokos" Sh.A, Prishtinë Prishtina 100%
2. Ngrohtorja e Qytetit "Gjakova" Sh.A, Gjakovë Gjakova 100%
3. Kompania Rajonale e Mbeturave "Çabrati" Sh.A, Gjakovë Gjakova 100%
4. Kompania e Mbeturave "JKP Standard", Mitrovicë Mitrovica 100%
5. Kompania e Mbeturave "JKSP Zveçan", Zveçan Zveçan 100%
6. Kompania e Ujësjes dhe Mbeturave "Ibri", "Zubin Potok" Zubin Potoku 100%
7. Kompania e Ujësjes dhe Mbeturave "24 Nëntori", Leposaviq Leposaviq 100%



8. Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Bifurkacioni" Sh.A, Ferizaj Ferizaj 85.3% Kaçanik 14.7%

9. Ndërmarrja Publike Banesore, Prishtinë, Prishtina 100%

10. NP Tregu, Mitrovicë, Mitrovica 100%

11. Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi" Sh.A, Prishtinë

12. Kompania Rajonale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A, Pejë

13. Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastërtia" Sh.A, Ferizaj

14. Kompania Rajonale e Mbeturinave "Eco-Regjioni" Sh.A, Prizren

15. Kompania Rajonale e Mbeturinave "Higjiena" Sh.A, Gjilan

16. Kompania Rajonale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A, Mitrovicë

## **BAZA LIGJORE E THEMELIMIT DHE E FUNKSIONIMIT TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE**

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 160 të saj ka përcaktuar se shteti ynë do t'i ketë në pronësi të vet të gjitha ndërmarrjet që janë në pronësi publike. Të gjitha obligimet që kanë të bëjnë me këto të drejta pronësore do të jenë obligime të Republikës së Kosovës. Qeveria e Kosovës mund të privatizojë, të japë me koncesion ose të japë me qira ndërmarrjet në pronësi publike në mënyrën e rregulluar me ligj<sup>24</sup>.

Ligji bazik, i cili vendos normat për formën e menaxhimit, raportimit, pronësisë, etj, është Ligji për Ndërmarrje Publike, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 13.06.2008 dhe i ndryshuar e plotësuar më 20.04.2012. Me këtë ligj është vendosur korniza ligjore për rregullimin e ushtrimit të të drejtave pronësore në ndërmarrjet publike, qeverisje korporative të ndërmarrjeve në përputhje me parimet e njohura ndërkombëtare për qeverisjen korporative të ndërmarrjeve publike si dhe janë përcaktuar struktura efikase të raportimit dhe përgjegjësia për të lejuar mbikëqyrjen e duhur të aktiviteteve të ndërmarrjeve publike. Gjithashtu, sipas këtij ligji është paraparë edhe vendosja e bordeve të drejtorëve për këto ndërmarrje. Këtyre bordeve, me synimin e udhëheqjes profesionale, u është dhënë detyra e menaxhimit të ndërmarrjeve publike, caktimit të caceve të zhvillimit të kompanisë, etj.

Megjithatë, përmbajtjen e këtij Ligji e konteston deputeti Visar Ymeri. Sipas tij, Ligji për Ndërmarrjet Publike është i dykuptimtë. "Nuk është e qartë

24 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 160 i. Gjetet në: <http://www.kushtetutakosoves.info/>

nëse këto ndërmarrje janë në pronësi të publikut apo janë ndërmarrje që ofrojnë shërbime për publikun dhe pronësohen nga qeveria. Ai po ashtu mendon se këto institucione duhet të barten tek Kuvendi i Kosovës, madje vendimet për tjetërsimin e tyre duhet të merren me shumicë të cilësuar të votave të deputetëve<sup>25</sup>”, vlerëson Ymeri.

Edhe Avni Zogiani aktivist i shoqërisë civile mendon se në Kosovë ekziston një keqkuptim rreth konceptit të Ndërmarrjeve Publike. “Ato nuk janë të pavarura , ato janë entitete të cilat praktikisht i udhëheqë ekzekutivi. Por fatkeqësisht në vendin tonë qeveria-ekzekutivi i ka dëmtuar këto institucione sepse i ka targetuar si vend ku mund të zhvillohet korrupsioni më i lartë qeveritar. Me qëllim që këto institucione të mbrohen nga ndikimi i drejtpërdrejt politik, duhet shtuar rolin e Kuvendit tek këto institucione, qoftë në emërimin e organeve udhëheqëse apo edhe në mbikëqyrjen e funksionimit të tyre<sup>26</sup>”, thotë Zogiani.

---

25 Visar Ymeri, deputete – shef i Grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje.  
Intervistë personale

26 Avni Zogiani, Drejtor ekzekutiv i Organizatës “QOHU”

## BORDET E NDËRMARRJEVE PUBLIKE NË KOSOVË

Ndërmarrjet Publike në Kosovë vazhdojnë të jenë pikë e dobëte organizimit institucional sa i përket përbërjes dhe funksionimit të bordeve udhëheqëse të tyre. Raporte të ndryshme vazhdojnë të drejtojnë kritika të shumta në adresë të këtyre institucioneve. Ajo që më së tepërmi bie në sy është propozimi dhe përzgjedhja e njerëzve të afërt me partitë politike në pushtet.

Megjithëse organizimi, përzgjedhja dhe funksionimi kanë bazë ligjore, në të shumtën e rasteve, Ndërmarrjet Publike kanë rënë ndesh me legjislacionin. Në këtë aspekt, janë evidentuar raste të ndikimeve politike në përfshirjen e njerëzve të politikës në bordet udhëheqëse, si dhe raste të konfliktit të interesit.

Sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Nr. 03/L-087, Nenit 17<sup>27</sup>, i cili përcakton kushtet e kualifikimit dhe përshtatshmërisë profesionale, një person ka të drejtë të shërbejë si drejtor vetëm nëse i plotëson të gjitha kushtet që të mos ketë qenë i dënuar për vepra penale, nuk ndodhet në konflikt interesi, profesional, jopolitik, etj.

Ndërkohë, sa i përket performancës së bordeve të Ndërmarrjeve Publike qendrore, institucionet kompetente e vendore kanë dhënë vazhdimisht vërejtje. Ato kryesisht lidhen me menaxhim jo të mirë financiar dhe mungesë të llogaridhënies karshi publikut.

Zyra e Auditorit Gjeneral në raportet e performancës për vitin 2012 ka paraqitur një varg rekomandimesh që do të duhej të merren parasysh në mënyrë që të përmirësohet performanca e tyre. Rekomandimet e këtij institucioni drejtuar qeverisë dhe të cilat u prezantuan vitin e kaluar kishin të bënin me: Rritjen e nivelit të llogaridhënies duke forcuar zbatimin e Ligjit të ndryshuar të NP-në në praktikë. Forcimi i llogaridhënies duke futur në përdorim sistemet e duhura të menaxhimit dhe mbikëqyrjes, fokusimi mbi aktivitetet e bordeve në përmirësimin e performancës për të siguruar funksionimin e procesit të të hyrave dhe një raportim të besueshëm financiar si dhe hartimin e udhëzuesve të unifikuar të menaxhimit, të cilët do të ndihmonin NP-të në rritjen e kultivimin e transparencës dhe ambientit të duhur të kontrollit<sup>28</sup>.

Në këtë raport gjithashtu përmenden edhe sfidat me të cilat ballafaqohen NP-të, siç janë: humbjet financiare, menaxhimi i prokurimit jo adekuat me kërkesat e aplikueshme, mungesë të kontrolleve të burimeve njerëzore, etj.

Në disa raste, raportet e Ndërmarrjeve Publike nuk kanë arritur të miratohen nga Kuvendi i Kosovës. Rasti i fundit lidhet me raportin e performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2012. Kuvendi i Kosovës nuk i dha vizën.

27 Ligji për Ndërmarrjet Publike, Nr. 03/L-087, Neni 17. Gjetet në: <http://gazetazyrtare.rks-gov.net/Documents/Microsoft%20Word%20%20ligji%20per%20ndermarrjet%20publike%2087%20lekturuar.%2024.06.2008.pdf>

28 ZAP, Raporti vjetor i Auditimit 2012, [http://oag-rks.org/repository/docs/RVA\\_2012\\_Shqip\\_923921.pdf](http://oag-rks.org/repository/docs/RVA_2012_Shqip_923921.pdf)

Për më tepër, edhe në raste të tilla mungon përgjegjësia dhe llogaridhënia. Edhe përkundër mosmiratimit të raporteve, institucionet përgjegjëse sikurse Qeveria nuk ndërmarrin asnjë masë për të kërkuar llogaridhënie dhe përgjegjësi. Qeveria e Kosovës, si aksionar i Ndërmarrjeve Publike, nuk ka marrë masa për shkarkimin e bordeve, performanca e të cilave është vlerësuar negativisht<sup>29</sup>.

Megjithatë, përveç vërejtjeve në performancë, ajo që konsiderohet më shqetësuese për opinionin, llogaritet ndërhyrja e interesave politike dhe partiake në zgjedhjen e drejtorëve të ndërmarrjeve.

## Mënyra e funksionimit të tyre

Shumica e bordeve të Ndërmarrjeve Publike funksionojnë me mandat nga viti 2008. Një numri të konsiderueshëm të tyre tashmë u ka skaduar mandati, por me vendime të veçanta, Qeveria ua ka zgjatur mandatin në disa Ndërmarrje Publike, sa për të mos ngecur punët.

Në një dëgjimi publik, përfaqësuesi i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Ramadan Sejdiu, ka bërë të ditur se drejtorët e bordeve në Ndërmarrjet Publike, të cilëve u ka mbaruar mandati, ju është zgjatur mandati me vendim të Qeverisë. Ai ka paralajmëruar përzgjedhjen e gjeneratës së dytë të anëtarëve të bordeve.

Funksionimi i organeve udhëheqëse të NP-ve ka qenë cak i kritikave të atyre që thirren në mbikëqyrjen e punës së NP-ve. Përpos që nuk e ka miratuar raportin, Kuvendi i Kosovës në mars të vitit 2013 ka shqyrtuar raportin e performancës së NP-ve dhe ka dhënë një varg kritikash.

Raporti kryesisht përmban informata lidhur me përgjegjësitë dhe detyrat e bordeve dhe të drejtorëve, si dhe detyrimet tjera të dala nga Ligji për ndërmarrjet publike, por nuk përmban ndonjë analizë për performancën e ndërmarrjeve publike. Pra, është më shumë përshkrim i ligjit dhe i referohet atij. Është me rëndësi të veçantë të theksohet se të gjitha këto ndërmarrje publike, përpos PTK-së, KEK-ut, KOST-it dhe Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, funksionojnë me humbje. Por, edhe ndërmarrje publike, të cilat operojnë me fitim, më 2011 u janë zvogëluar fitimet në krahasim me vitin paraprak<sup>30</sup>.

29 Agron Demi – Drejtor Ekzekutiv i Institutit GAP. Intervistë personale

30 Ali Sadriu, kryetar i Komisionit parlamentar për mbikëqyrjen e financave publike, transkript i seancës plenare, 29 mars 2013, [http://assemblykosova.org/common/docs/proc/trans\\_s\\_2013\\_03\\_29\\_10\\_4837\\_al.pdf](http://assemblykosova.org/common/docs/proc/trans_s_2013_03_29_10_4837_al.pdf)

Në raste të caktuara, shkaktar i performancës negative vlerësohet të jetë edhe mungesa profesionale e anëtarëve të bordeve të NP-ve. Shumica e ndërmarrjeve publike operojnë me humbje dhe një nga shkaktarët e kësaj performace jo të mirë është edhe emërimi i anëtarëve jo profesional dhe politik<sup>31</sup>.

Baza ligjore në raste të caktuara nuk vlerësohet se është pengesë apo e paplotësuar sa i përket funksionimit të NP-ve. Jo rrallë herë baza ligjore është e mjaftueshme, por duhet të shikohet se si zbatohet. Por, vendimi për Ligjin për Ndërmarrjet Publike ka qenë i mangët. Më shumë është marrë me çështjen e raportimit se sa me çështjen e rregullimit të vetë sistemit. Ai duhet të jetë gjithëpërfshirës e jo të përqendrohet në dy-tri çështje<sup>32</sup>. Ndërkohë, sa i përket funksionimit të KEK-ut, Bordi është organ i zgjedhur nga Qeveria që mbikëqyrë kompaninë, d.m.th është përfaqësues i aksionarit dhe automatikisht pritet të jetë profesional. Pra, nuk mund çdokush të zgjidhet anëtar i bordit të KEK-ut, sepse duhet të ketë njohuri mbi veprimtarinë dhe kjo normalisht që ndikon edhe në rezultatet e vetë kompanisë<sup>□</sup>.

## Zgjedhja e organeve drejtuese

Sipas Ligjit për Ndërmarrjet publike, Kreu III, Neni 15 që flet për Zgjedhjen e Drejtorëve të NP Qendrore thuhet se: Bordi i Drejtorëve të një NP-je qendrore do të përbëhet nga pesë (5) ose shtatë (7) drejtorë. Sipas këtij neni, numri i drejtorëve të cilësdo NP të caktuar qendrore do të mbetet i njëjtë me numrin e drejtorëve të NP-së në fjalë, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji; me kusht që, nëse, në këtë datë, NP-ja qendrore ka tetë (8) ose më shumë drejtorë, atëherë numri i drejtorëve të saj do të jetë shtatë (7). Po ashtu, ky nen parasheh që të gjithë drejtorët, përveç njërit, të zgjidhen nga Qeveria; dhe secili drejtor me mandat 3vjeçar . Drejtori tjetër do të jetë KE i NP-së dhe zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve të NP-së në përputhje me nenin 21 të këtij ligji. Gjatë zgjedhjes së drejtorëve të bordit të drejtorëve të një NP-je qendrore, Qeveria mund të zgjedhë vetëm personat të cilët i janë rekomanduar asaj nga Komisioni përkatës rekomandues i themeluar në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni. Gjatë zgjedhjes së drejtorëve, Qeveria duhet të sigurojë që së paku dy (2) drejtorë të jenë ekspert, ose së paku të kenë njohuri adekuate, të kontabilitetit, siç kërkohet nga neni 17.4 të këtij ligji<sup>33</sup>.

Ndërkohë, Neni tjetër 17.2 i këtij ligji fletë për pavarësinë që drejtorët e NP-ve duhet të kenë në momentin e përzgjedhjes. Sipas këtij neni, të gjithë drejtorët përveç KE-së, duhet të jenë të pavarur.

---

31 Agron Demi, Drejtor ekzekutiv i Institutit GAP. Intervistë personale  
32 Pranvera Dobruna, anëtare e bordit të KEK-ut. Intervistë personale  
33 Ligji për Ndërmarrjet Publike, Nr. 03/L-087, Kreu III, Neni 15.

Ligji po ashtu ka përcaktuar edhe kriteret sipas të cilave një person nuk mund të kualifikohet për t`u zgjedhur drejtor në një NP. Kriteret e tilla janë: a) nëse aktualisht është zyrtar ose menaxher i NP-së përkatëse ose cilëso nga filialet e saj, ose ka shërbyer si zyrtar ose menaxher i NP-së përkatës e ose cilëso nga filialet e saj brenda pesë (5) viteve të kaluara; b) aktualisht është punonjës i nivelit të lartë i NP-së përkatëse, ose ka shërbyer si punonjës i nivelit të lartë në NP-në përkatëse brenda tri (3) viteve të kaluara; c) aktualisht ka, ose gjatë tri viteve të kaluara ka pasur, çfarëdo marrëdhënie materiale afariste (përveç si konsumator individual i shërbimeve të NP-së) me NP-në përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë□.

Zgjedhja e organeve drejtuese ka qenë shpeshherë edhe arenë përballjesh në Kuvendin e Kosovës. Shpeshherë, propozimet e Qeverisë kanë gjetur kundërshtimin e Kuvendit gjatë votimit. Mirëpo, në shumicën e rasteve, edhe pas refuzimit të emrave të caktuar, Qeveria nuk ka bërë ndryshime, duke i sjellë të njëjtit emra. Situata e tillë kanë përfunduar me përzgjedhjen e tyre, pas "pajtitit" të subjekteve që kanë synuar t'i fusin njerëzit e afërt të tyre me partitë politike. Sipas vendimeve të Qeverisë, gjatë tri viteve të kaluara, shumica e të propozuarve nga hera e parë kanë marrë në fund miratimin edhe të Kuvendit.

Praktika të tilla janë kritikuar shumë herë nga shoqëria civile. Zgjedhja e personave në baza partiake dhe joprofesional ka qenë edhe rezultati i dobët i performancës së NP-ve në përgjithësi, duke mos përjashtuar as Ndërmarrjet Publike lokale.

## Politizimi mbi baza partiake

“Betejat” e subjekteve politike në pushtet për të inkuadruar njerëzit e afërt me politikën dhe mbi baza klienteliste kanë qenë fenomen i të gjitha atyre forcave politike që kanë qenë në pushtet ndër vite. Ndërmarrjet Publike qendrore kanë qenë vendi më i përshtatshëm për rehabilitimin dhe sistemimin e militantëve partiak.

Një numër i konsiderueshëm i anëtarëve të bordeve të NP-ve dhe udhëheqësve, vijnë nga strukturat partiake. Raste të shumta janë edhe publike në ueb faqet e NP-ve që paraqesin përbërjet e bordeve. PTK-ja në strukturat menaxhuese ka njerëz të afërt me partitë politike, siç është rasti me kryeshefin ekzekutiv z. Sejdi Hoxha, i cili ka lidhje familjare (nip) me anëtarin e Kryesisë së PDK-së Azem Sylja. Në strukturat menaxhuese të po kësaj ndërmarrje është edhe Demir Limaj, vëllai i ish- ministrit të Transportit, Fatmir Limaj, si dhe Bardhyl Sejdiu, djali i ish-kryetarit të LDK-së dhe ish presidentit të vendit, Fatmir Sejdiu. Edhe në ndërmarrjen “TrainKos”, Heset Cakolli nga AKR-ja ndodhet në strukturën menaxhuese. Të papolitizuara nuk kanë mbetur as Ndërmarrja hidroekonomike “Ibër-Lepenci”, në krye të së cilës është vendosur Hajdar Beqa, anëtar i KD të PDK-së. Pastaj, Arsim Janova nga kryesia e LDK-së, në krye të Ngrohtores së Qytetit “Termokos” në Prishtinë.

Për shoqërinë civile, ky fenomen i ka bazat nga periudhat e hershme të ndërtimit të institucioneve kosovare. Agron Demi nga GAP-i, vlerëson se politizimi i Ndërmarrjeve Publike ka filluar që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës. Sipas tij, një nga intervenimet e para të Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar (ICO) ndaj vendimeve të Qeverisë së Kosovës ishte pikërisht kundër politizimit të bordeve të ndërmarrjeve publike. Në dhjetor të 2008, Qeveria e Kosovës e përbërë atë kohë nga koalicioni PDK-LDK, mori 15 vendime në bazë të të cilave emëroi anëtarët e bordeve të Ndërmarrjeve Publike. Këto emërime u kritikuan dhe Qeveria u detyrua që në prill 2009 të bëj disa ndryshime në anëtarësinë e bordeve, por në masë të madhe u emëruan anëtarët e partive në pushtet<sup>34</sup>. Sipas Demit, nga ajo kohë, Qeveria vetëm u ka vazhduar mandatin anëtarëve të bordeve të Ndërmarrjeve Publike, edhe pse performanca e tyre është vlerësuar të jetë e dobët. Për shembull, Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, për çdo vit bën vlerësimin e performancës së bordeve të Ndërmarrjeve Publike dhe në shumicën e rasteve bordet vlerësohen negativisht. Përkundër kësaj, Qeveria nuk ka ndërmarrë masa në emërimin e profesionistëve në bordet e tilla publike”.

34 Agron Demi- Drejtor ekzekutiv i Institutit GAP. Intervistë personale

Politizimi i skajshëm i këtyre institucioneve kishte detyruar në vitin 2009 Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar (PNC), që të kërkoj nga Qeveria të largojë të paktën 12 persona nga bordet e NP-ve për shkak të politizimit të tyre<sup>35</sup>. Për më tepër, ankesa e PNC-së, kishte të bënte edhe me faktin se emrat të cilët qeveria i ka përzgjedhur për borde të drejtorëve nuk i janë dërguar qeverisë nga Komisioni Përzgjedhës i paraparë me ligj.

Kritika për politizimin e organeve udhëheqëse të Ndërmarrjeve Publike, jo rrallë herë kanë qenë arenë e diskutimeve të ashpra edhe në seancat plenare të Kuvendit të Kosovës. Përkundër debateve dhe kritikave të fuqishme nga ana e deputetëve, institucionet e vendit përkatësisht qeveria e vendit akoma nuk ka reflektuar. Është konstatim i përgjithshëm që ky ngërç ndodh vetëm për shkak të pazarllëqeve politike ndërmjet partnerëve të koalicionit qeverisës.

---

35 Për një listë complete të emrave shikoni: Instituti GAP, Monitor i Vendimeve të Qeverisë të Kosovës, 4 Prill 2009, faqe 3-4 ose Aneksi II në këtë punim.



## KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË TË ARDHURAVE DHE MËDITJEVE

Mungesa e Ligjit për përcaktimin e pagave të zyrtarëve të lartë po bënë që udhëheqësit e Ndërmarrjeve publike dhe të Agjencive të Pavarura të përfitojnë paga të mëdha, shkaku i mungesës së harmonizimit. Për më tepër, dallim i madh vërehet edhe nga njëri institucion i pavarur tek tjetri.

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe disa institucione të tjera që vlerësohen se kanë veprimtari më specifike, përfitojnë paga shumëfish më të larta se sa drejtuesit e lartë të institucioneve shtetërore.

Vendimet e Qeverisë për kompensimin financiar të NP-ve, flasin për shumta të mëdha parash në raport me të ardhurat e udhëheqësve të institucioneve tjera. Në vendimin e Qeverisë të vitit 2009, për bordin e drejtorëve të PTK-së, për honorare themelore, 850 euro ndahen për kryesuesin, ndërkaq nga 750 për anëtarët e bordit. Ndërkohë, për menaxhmentin, përkatësisht kryeshefin ekzekutiv përcaktohet paga prej 5 mijë e 182.24 euro bruto.

Drejtori menaxhues i KEK-ut ka një pagë mujore bruto prej 2 mijë e 800 euro. Vendimet qeveritare kanë shpërblyer me paga të mira edhe udhëheqësit e Ndërmarrjeve tjera Publike, si p.sh në NPH "Ibër – Lepenci" Sh.A, paga e kryeshefit ekzekutiv arrin vlerën në 1.980 euro.

Më 13 mars 2013, Qeveria e Kosovës ka miratuar rregullat për lartësinë e kompensimit të anëtarëve të bordeve të kompanive qendrore publike sipas kategorizimit. Në kategorinë e parë të kompanive publike janë: Postë Telekomit i Kosovës, Korporata Energjetike e Kosovës, Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) dhe Posta e Kosovës<sup>36</sup>.

Vetëm bordi i drejtorëve i katër kompanive më të mëdha publike i kushton buxhetit të Kosovës rreth 300 mijë euro në vit, në emër të kompensimit financiar të kryesuesve dhe anëtarëve të bordit, pa i përfshirë këtu edhe bonuset që i kanë përfituar deri më tani.

Sipas këtij vendimi, kryesuesit e bordeve të këtyre ndërmarrjeve paguhen nga 850 euro në muaj, plus 200 euro për komisione të auditimit dhe 150 euro për komitetet tjera, respektivisht 1200 euro në muaj. Ndërsa anëtarët e bordeve kanë pagë prej 750 euro, 150 euro i marrin për komisionin e auditimit dhe 150 euro për komitetet e tjera.

36 Vendimi i Qeverisë së Kosovës. Gjetet në: [http://ëëë.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet\\_e\\_mbledhjes\\_se\\_119-te\\_te\\_Qeverise\\_2013.pdf](http://ëëë.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_mbledhjes_se_119-te_te_Qeverise_2013.pdf)

Një risi në raport me veprimet e kaluara të NP-ve është shembulli i KEK-ut. Kjo ndërmarrje ka ndërmarrë nismën për rishqyrtim të të ardhurave dhe mëditjeve.

Pranvera Dobruna, anëtare e bordit të KEK-ut, tregon se në kuadër të bordit të kësaj ndërmarrje është përzgjedhur një komitet që do të merret me këto çështje, pasi ka pakënaqësi ndërmjet punëtorëve. Sipas saj ky komitet do ta këshillojë bordin në mënyrë që të silltet një vendim i drejtë. Ne kemi kërkuar që të rishqyrtohet kjo çështje, ku do të përcaktohen termat e referencës për secilën përgjegjësi<sup>37</sup>, ka shtuar Dobruna.

---

37 Pranvera Dobruna, anëtare e bordit të KEK-ut. Intervistë personale

## RAPORTIMI PËR PUNËN E NDËRMARRJEVE PUBLIKE

Sa i përket raportimit dhe llogaridhënies, legjislacioni i aplikueshëm e ngarkon Qeverinë si përgjegjëse para Kuvendit. Qeveria i përgjigjet Kuvendit për mënyrën në të cilën ajo, Ministri dhe Njësia për Politikën dhe Monitorimin e NP-të, i ushtrojë kompetencat dhe përgjegjësitë të cilat u janë dhënë me këtë ligj. Ligji ka përcaktuar që Qeveria duhet t'i raportojë Kuvendit në bazë vjetore mbi performancën e këtyre autorizimeve dhe përgjegjësve si dhe mbi arritjen e objektivave të përcaktuara në politikën e pronësisë të përcaktuar në nenin 6.1 të këtij ligji. Po ashtu obligohet Qeveria që të sigurojë të dhëna kuantitative dhe të qëndrueshme publikut dhe Kuvendit mbi mënyrën e menaxhimit të NP-ve Qendrore në interes të Republikës së Kosovës<sup>38</sup>.

Përfaqësues të ndërmarrjeve publike vlerësojnë se në përgjithësi respektohen afatet ligjore për raportim. Ne komunikojmë me Qeverinë nëpërmjet njësive për monitorimin e Ndërmarrjeve Publike në MZHE. Kryesuesi i bordit raporton tek ministria. Raportimi është i paraparë njëherë në vit<sup>39</sup>.

Megjithatë të dhënat e disponueshme për publikun, të cilat dëshmojnë edhe me rastin kur Kuvendi ka refuzuar miratimin e raporteve që i paraqiten nga ana e Qeverisë së Kosovës, kanë nxjerrë konkluzione se disa nga Ndërmarrjet Publike nuk kanë performuar siç duhet. Si pasojë e mosfunksionimit dhe performancës jo të mirë, shihet edhe rreziku i vijimësisë së NP-ve. Përkundër angazhimit të bordeve të ndërmarrjeve publike, performanca e disa prej kompanive ka vazhduar të përcillet me humbje të konsiderueshme. Kjo performancë negative rrezikon seriozisht vijimësinë e këtyre ndërmarrjeve. Kontrollat jo adekuate në përgjithësi tregojnë se menaxhmentet e këtyre ndërmarrjeve ende nuk kanë siguruar mjedis funksional të kontrollit në mënyrë që të sigurojnë menaxhim efektiv dhe efikas të parasë publike<sup>40</sup>.

38 Ligji për ndërmarrjet publike, Nr. 03/L-087, Neni 8, pika 1.

39 Pranvera Dobrunën, anëtare e bordit të KEK-ut. Intervistë Personale

40 ZAP, Raporti vjetor i Auditimit 2012, [http://oag-rks.org/repository/docs/RVA\\_2012\\_Shqip\\_923921.pdf](http://oag-rks.org/repository/docs/RVA_2012_Shqip_923921.pdf)

## Rekomandime:

- KDI-ja rekomandon që të plotësohet dhe ndryshohet Ligji për Ndërmarrje Publike, me qëllim të qartësimit të normave për rritjen e efikasitetit të mbikëqyrjes së NP-ve gjë që do të mundësojë një performancë në dobi të shërbimeve më cilësore për qytetarët;
- Ndryshimet e Ligjit duhet të reflektojnë në depolitizimin e organeve udhëheqëse të NP-ve dhe në politikat e kompensimit dhe përfitimeve të bordeve të drejtorëve;
- Kuvendi i Kosovës duhet të fuqizojë rolin tek këto institucione, qoftë në emërimin e organeve udhëheqëse apo edhe në mbikëqyrjen e funksionimit të tyre;
- Duhet të fuqizohet roli i Kuvendit të Kosovës, në vendimet për tjetërsimin e tyre. Vendimet e tilla duhet të merren me shumicë të cilësuar të votave të deputetëve;
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik të fuqizoj rolin e Njesisë për Politika dhe Monitorim (NJPM) të Ndërmarrjeve Publike në aspektin e mbikëqyrjes së Ndërmarrjeve publike;
- Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës të ndërmarrin masa ndaj bordeve udhëheqëse të NP-ve, të cilat nuk kanë performuar mirë.

## SHTOJCA 1. Të dhënat për mandatin e anëtarëve të organeve udhëheqëse të Agjencive të Pavarura

Agjencia Kundër Korrupsion

Nr.	Emri	Pozita	Fillimi i mandatit	Skadimi i mandatit
1	Hasan Preteni	Kryetar	23/09/2011	23/09/2016

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës

Nr.	Emri	Pozita	Fillimi i mandatit	Skadimi i mandatit
1	Alan Pickering	Anëtar	01/08/2012	31/07/2015
2	Driton Qehaja	Anëtar	01/08/2012	31/07/2015
3	Frederick Artesani	Anëtar	22/10/2011	21/10/2014
4	Leendert Van Driel	Anëtar	01/08/2012	31/07/2015
5	Ruzhdi Morina,	Anëtar	01/08/2012	31/07/2015
6	Ymer Havolli	Kryesues	01/08/2012	31/07/2015

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

Nr.	Emri	Pozita	Fillimi i mandatit	Skadimi i mandatit
1	Ahmet Tmava	Kryetar	28/01/2010	28/01/2014
2	Ibush Jonuzi	Anëtar	28/10/2010	28/01/2014
3	Ramiz Krasniqi	Anëtar	08/12/2011	08/12/2015
4	Shaip Latifi	Anëtar	28/10/2010	28/01/2014
5	Xhevdet Kastrati	Anëtar	28/10/2010	28/01/2014

Agjencia Shtetërore për Mbrotjen e të Dhënave Personale

Nr.	Emri	Pozita	Fillimi i mandatit	Skadimi i mandatit
1	Akesander Spasiq	Mbikqyrës shtetëror	04/05/2011	04/05/2016
2	Bekim Demiri,	Mbikqyrës shtetëror	04/05/2011	04/05/2016
3	Mentor Hoxhaj,	Mbikqyrës shtetëror	04/05/2011	04/05/2016
4	Ramadan Qehaja	Mbikqyrës shtetëror	04/05/2011	04/05/2016
5	Ruzhdi Jashari	Mbikëqyrës kryesor	04/05/2011	04/05/2016

Agjencioni Kosovar për Prona - Bordi Mbikëqyrës

Nr.	Emri	Pozita	Fillimi i mandatit	Skadimi i mandatit
1	Marisa Cohrs	Kryesuese e Bordit	30/08/2013	31/08/2014
2	Ian Cliff	Anëtar i Bordit	22/08/2014	31/08/2014
3	Ismail Osdautaj	Anëtar i Bordit	15/11/2013	14/11/2014
4	Markus Josef Baechler	Anëtar i Bordit	22/08/2014	31/08/2014
5	Ujup Krasniqi	Anëtar i Bordit	15/11/2013	14/11/2014

Agjencioni Kosovar për Prona - Komisioni për Kërkesa Pronësore

Nr.	Emri	Pozita	Fillimi i mandatit	Skadimi i mandatit
1	Adem Vokshi,	Anëtar i Komisionit	25/04/2013	25/04/2014
2	Norbert Euhler,	Anëtar i Komisionit	31/08/2013	31/08/2014
3	Veijo Heiskainen	Kryesues i Komisionit	31/08/2014	31/08/2014

Agjencioni Kosovar për Prona - Sekretariati Ekzekutiv

Nr.	Emri	Pozita	Fillimi i mandatit	Skadimi i mandatit
1	Scott Boëen	Drejtor i Sekretariatit Ekzekutiv	29/06/2012	31/08/2014
2	Xhevat Azemi	Zëvendës Drejtor i Sekretariatit	30/09/2011	30/09/2015

## Banka Qendrore e Kosovës

	<b>Emri</b>	<b>Pozita</b>	<b>Fillimi i mandatit</b>	<b>Skadimi i mandatit</b>
1	Bedri Hamza	Guvernator	14/03/2013	14/03/2018
2	Bedri Peci	Anëtar	28/02/2013	28/02/2018
3	Fatmir Plakiqi	Drejtori i Thesarit	26/07/2015	26/07/2015
4	Mejdi Bektashi	Anëtar	15/05/2009	14/05/2014
5	Sejdi Rexhepi	Kryetar i Bordit	13/06/2008	12/06/2013

## Instituti Gjyqësor i Kosovës

<b>Nr.</b>	<b>Emri</b>	<b>Pozita</b>	<b>Fillimi i mandatit</b>	<b>Skadimi i mandatit</b>
1	Albert Avdiu	Drejtor i SE- Këshillit Gjyqësor	25/05/2012	25/05/2014
2	Bedri Bahtiri	Sekertar i Përhershëm, MD/ Qeveri	25/05/2012	25/05/2014
3	Enver Peci	Kryesues, Këshilli Gjyqësor i Kosovës	25/05/2012	25/05/2014
4	Fejzullah Hasani	Kryetar, Gjykata Supreme	25/05/2012	25/05/2014
5	Idain Ismaili	Prokuror, Shoqata e Prokurorëve	25/05/2012	25/05/2014
6	Laura Pula	Prokurore, Prokuroria e shtetit	25/05/2012	25/05/2014
7	Nebojsha Boriqiq	Gjyqtar, Gjykata Supreme	25/05/2012	25/05/2014
8	Osman Ismaili	Profesor, Fakulteti Jurdik	25/05/2012	25/05/2014
9	Ramë Gashi	Avokat, Oda e Avokatëve të Kosovës	25/05/2012	25/05/2014
10	Rexhep Murati	Profesor, Fakulteti Jurdik	25/05/2012	25/05/2014
11	Susan Heintz	OSBE	18/04/2012	12/06/2012
12	Ymer Hoxha	Gjyqtar, Shoqata e Gjyqëtarëve	25/05/2012	25/05/2014

## Këshilli për Ndihmë Juridike Falas

Nr.	Emri	Pozita	Fillimi i mandatit	Skadimi i mandatit
1	Afrim Shala	Gjykata Supreme e Kosovës	08/11/2012	08/11/2015
2	Alban Sutaj	Ministria e Drejtësisë	08/11/2012	08/11/2015
3	Armend Krasniqi	Oda e Avokatëve	08/11/2012	08/11/2015
4	Bahrije Berisha	Ministria e Financave	08/11/2012	08/11/2015
5	Fadil Rracaj	Ministria e Mirëqenies Sociale	08/11/2012	08/11/2015
6	Nenad Stojqetovic	Ministria për Komunitete e Kthim	08/11/2012	08/11/2015
7	Shukrije Gashi	Anëtare nga OJQ " Partners Kosova"	08/11/2012	08/11/2015

## Organi Shqyrtues i Prokurimit

Nr.	Emri	Pozita	Fillimi i mandatit	Skadimi i mandatit
1	Osman Kryeziu	Anëtar	03/06/2011	22/11/2013
2	Hysni HOXHA	Kryetar	30/07/2008	31/07/2013
3	Tefik Sylejmani	Anëtar	30/07/2008	31/07/2013
4	Ekrem Salihu	Anëtar	31/07/2008	31/07/2012
5	Demë Keka	Anëtar	2010	Dorëheqje
6	Baki Krasniqi	Anëtar	31/07/2008	31.07.2012



## Autoriteti i Aviacionit Civil

Nr.	Emri	Pozita	Fillimi i mandatit	Skadimi i mandatit
1	Arsim Cakaj	Anëtar	03/07/2009	03/07/2013
2	Asman Hoxha	Anëtar	03/07/2009	03/07/2012
3	Avni Mazreku	Anëtar	03/07/2009	03/08/2012
4	Fitim Shala	Anëtar	03/07/2009	03/07/2013
5	Kosum Kosumi	U.D i Kryesuesit	25/09/2009	25/09/2013

## Zyra e Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim

Nr.	Emri	Pozita	Fillimi i mandatit	Skadimi i mandatit
1	Raif Preteni	Drejtor	15/04/2010	14/04/2015
2	Kero Bardhi	Zëvendësdrejtor	15/04/2010	14/04/2015

## Komisioni Shqyrtues në Zyrën e Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim

Nr.	Emri	Pozita	Fillimi i mandatit	Skadimi i mandatit
1	Ylber Aliu	Kryesues	16/06/2011	16/06/2014

## Avokati i Popullit

Nr.	Emri	Pozita	Fillimi i mandatit	Skadimi i mandatit
1	Basri Berisha	Zëvendës	07/10/2011	06/10/2014
2	Bogoljub Staletovic	Zëvendës	07/10/2011	06/10/2014
3	Ibrahim Arslan	Zëvendës	07/02/2011	06/10/2014
4	Isa Hasani	Zëvendës	07/10/2011	06/10/2014
5	Sami Kurteshi	Avokat i Popullit	04/06/2009	03/06/2014
6	Shqipe Ibraj – Mala	Zëvendëse	07/10/2011	06/10/2014

## Këshilli Gjyqësor i Kosovës

<b>Nr.</b>	<b>Emri</b>	<b>Pozita</b>	<b>Fillimi i mandatit</b>	<b>Skadimi i mandatit</b>
1	Agim Maliqi	Anëtar i KGJK	07/07/2011	06/02/2007
2	Asllan Krasniqi	Anëtar i KGJK	07/07/2011	06/07/2016
3	Enver Peci	Kryesues i Këshillit Gjyqësor	11/03/2013	10/03/2018
4	Gerrit Marc Sprenger	Anëtar i KGJK	23/12/2010	22/12/2015
5	Malcolm Simmons	Anëtar i KGJK	18/04/2011	17/04/2016
6	Muharrem Shala	Anëtar i KGJK	11/11/2010	10/11/2015
7	Nebojsa Boricic	Anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	21/12/2011	20/11/2016
8	Raima Rama Elezi	Anëtare e Këshillit Gjyqësor të Kosovës	21/12/2011	20/11/2016
9	Salih Mekaj	Anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	21/12/2011	20/11/2016
10	Valdete Daka	Anëtare e KGJK	19/03/2010	18/03/2015
11	Zhivojin Jokanovic	Anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	25/08/2009	24/08/2014

## Zyra e Rregullatorit për Energji

<b>Nr.</b>	<b>Emri</b>	<b>Pozita</b>	<b>Fillimi i mandatit</b>	<b>Skadimi i mandatit</b>
1	Blerim Koci	Anëtar	15/12/2008	15/12/2013
2	Enver Halimi	Kryetar	15/05/2012	15/05/2017
3	Krenar Bujupi	Anëtar	15/05/2012	15/05/2017
4	Merita Kostari	Anëtar	15/05/2012	15/05/2017
5	Përparim Kabashi	Anëtar	15/12/2008	15/12/2013

## Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave të Kosovës

<b>Nr.</b>	<b>Emri</b>	<b>Pozita</b>	<b>Fillimi i mandatit</b>	<b>Skadimi i mandatit</b>
1	Gëzim Qerimi	Anëtar	01/04/2010	01/04/2014
2	Halit Gara	Anëtar	01/04/2010	01/04/2014
3	Ilmi Ahmeti	Anëtar	01/04/2010	01/04/2014

## Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

<b>Nr.</b>	<b>Emri</b>	<b>Pozita</b>	<b>Fillimi i mandatit</b>	<b>Skadimi i mandatit</b>
1	Gjylnaze Novobërdali - Gola	Anëtare	12/12/2013	11/12/2018
2	Hajzer Salihu	Anëtar	12/12/2013	11/12/2018
3	Irena (Svetic) Ahmeti	Anëtare	23/07/2009	23/07/2014
4	Lulëzim Aliaj	Anëtar	12/12/2013	11/12/2018
5	Naim Abazi	Anëtar	29/01/2010	29/01/2015
6	Sabile Avdyli	Anëtare	23/07/2009	23/07/2014
7	Shkëmb Manaj	Anëtar	12/12/2013	11/12/2018

Agjencia Kosovare për Privatizim

<b>Nr.</b>	<b>Emri</b>	<b>Pozita</b>	<b>Fillimi i mandatit</b>	<b>Skadimi i mandatit</b>
1	Blerim Rexha	Kryesues	21/02/2013	16/05/2013 ( dorëheqja)
2	Dardane Peja	Anëtare	21/02/2013	21/02/2015
3	Dardane Peja	Anëtare	21/02/2013	16/05/2013 ( dorëheqja)
4	Haxhi Arifi	Anëtar	21/02/2013	21/02/2015
5	Maja Milanoviq	Anëtare	21/02/2013	21/02/2015
6	OKB Bernadette Roberts	Drejtor	31/08/2014	31/08/2014 (dorëheqje)
7	OKB Hubert Warsmann	Drejtor	31/08/2014	31/08/2014
8	OKB Mohammed Omran	Drejtor	31/08/2014	31/08/2014
9	Skender Komoni	Anëtar	21/02/2013	21/02/2015

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

<b>Nr.</b>	<b>Emri</b>	<b>Pozita</b>	<b>Fillimi i mandatit</b>	<b>Skadimi i mandatit</b>
1	Ilaz Duli	Anëtar	10/07/2010	10/07/2015
2	Safet Hoxha	Kryetar	10/07/2010	10/07/2015
3	Silvana Nikollqeviq	Anëtar	10/07/2010	10/07/2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

<b>Nr.</b>	<b>Emri</b>	<b>Pozita</b>	<b>Fillimi i mandatit</b>	<b>Skadimi i mandatit</b>
1	Lage Olofsson	Kryesues	09/03/2009	31/08/2014

## Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit

Nr.	Emri	Pozita	Fillimi i mandatit	Skadimi i mandatit
1	Besnik Berisha	Anëtar	17/09/2009	16/09/2014
2	Ekrem Hoxha	Kryetar	17/09/2009	16/09/2014
3	Lulzim Kurtaj	Anëtar	17/09/2009	16/09/2014
4	Naser Shala	Anëtar	17/09/2009	16/09/2014
5	Nijazi Ademaj	Anëtar	17/09/2009	16/09/2014

## Bordi për Ankesa të Mediave

Nr.	Emri	Pozita	Fillimi i mandatit	Skadimi i mandatit
1	Albion Kelmendi	Anëtar	05/11/2012	05/11/2015
2	Daut Krasniqi	Anëtar	05/11/2012	05/11/2015
3	Sylejman Klinaku	Anëtar	05/11/2012	05/11/2015

## Komisioni i Pavarur për Media

Nr.	Emri	Pozita	Fillimi i mandatit	Skadimi i mandatit
1	Drita Begolli	Anëtar	30/08/2012	30/08/2016
2	Emrush Kastrati	Anëtar	30/08/2012	12/09/2013
3	Nevzat Hydaverdi	Anëtar	30/08/2012	30/08/2014
4	Shefki Ukaj	Anëtar	30/08/2012	30/08/2014 (është shkarkuar)
5	Vesna Jovanovic	Anëtar	30/01/2013	30/01/2016 (është shkarkuar)
6	Xhemajl Krasniqi	Anëtar	30/08/2012	30/01/2016

## Bordi për Rishqyrtimin e Ankesave

Nr.	Emri	Pozita	Fillimi i mandatit	Skadimi i mandatit
1	Agron Kajtazi	Anëtar	23/09/2011	23/09/2013
2	Artan Qerkini	Anëtar	28/06/2012	31/12/2012
3	Dragan Djorgovic	Anëtar	28/06/2012	31/12/2012
4	FaiK Çollaku	Anëtar	12/10/2012	31/12/2013
5	faruk Prebeza	Anëtar	23/09/2011	23/09/2013
6	Hyda Hajrullahu- Dallku	Anëtar	23/09/2011	23/09/2013
7	Nexhat Hasani	Anëtar	12/10/2012	31/12/2013
8	Përparim Hoxha	Anëtar	12/10/2012	31/12/2013
9	Refik Ramaj	Anëtar	<b>28/06/2012</b>	31/12/2012
10	Samir Lleshi	Anëtar	12/10/2012	31/12/2013
11	Shukri Hoxha	Anëtar	23/09/2011	23/09/2013
12	Skender Kolgeci	Kryesues	23/09/2011	23/09/2013
13	Vlora Zhushi	Anëtar	23/09/2011	23/09/2013

## Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës

Nr.	Emri	Pozita	Fillimi i mandatit	Skadimi i mandatit
1	Idriz Blakaj	Drejtor i Agjencisë	12/07/2013	12/07/2018

## Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore

Ky institucion i pavarur, që nga data viti 2010 , ende funksionon pa bord.

Bordi i Radio Televizionit të Kosovës – RTK

<b>Nr.</b>	<b>Emri</b>	<b>Pozita</b>	<b>Fillimi i mandatit</b>	<b>Skadimi i mandatit</b>
1	Afërdita Maliqi	Anëtare	15/11/2013	15/11/2016
2	Aleksandër Janjeqevic	Anëtar	15/10/2009	15/10/2013
3	Besa Bytyçi	Anëtare	30/01/2013	30/01/2016
4	Elif Tokmak	Anëtar	02/05/2013	02/05/2016
5	Fadil Bajraktari	Anëtar	30/08/2012	30/08/2015
6	Faton Mehmetaj	Anëtar	30/01/2013	30/01/2016
7	Ismet Behxheti	Anëtar	30/08/2012	30/08/2015
8	Ivan Veljkovic	Anëtar	30/08/2012	30/08/2015
9	Majlinda Hajrullahu	Anëtar	30/08/2012	30/08/2015
10	Naime Beqiraj	Anëtare	15/11/2013	14/11/2016
11	Rrahman Paçarizi	Kryesues	30/08/2012	30/08/2015

## Gjykata Kushteuese e Kosovës

<b>Nr.</b>	<b>Emri</b>	<b>Pozita</b>	<b>Fillimi i mandatit</b>	<b>Skadimi i mandatit</b>
1	Altay Suroy	Gjyqtar	13/06/2009	12/06/2015
2	Arta Rama - Hajrizi	Gjyqtare	25/06/2012	24/06/2021
3	Enver Hasani	Kryetar	13/06/2009	12/06/2015
4	Ivan Cukalovic	Gjyqtar	12/06/2009	13/06/2015
5	Kadri Kryeziu	Zëvendëskryetar	13/06/2009	12/06/2015

Komisioni Kosovar i Konkurencës

<b>Nr.</b>	<b>Emri</b>	<b>Pozita</b>	<b>Fillimi i mandatit</b>	<b>Skadimi i mandatit</b>
1	Ahmet Krasniqi	Kryesues	21/11/2008	24/11/2013
2	Deniz Jonuzi	Anëtar	24/11/2008	24/11/2011
3	Gani Asllani	Anëtar	29/04/2010	29/04/2015
4	Halit Shabani	Anëtar	24/11/2008	24/11/2013
5	Osman Jakupi	Anëtar	24/11/2008	24/11/2011



## Këshilli Kombëtar i Shkencës

Lista me këto propozime të Qeverisë me emërat për anëtarë të Këshillit Kombëtarë të Shkencës si më poshtë nuk është miratuar në Kuvendin e Kosovës, më 23.09.2012. Nga ajo kohë qeveria nuk ka sjellur propozime të tjera.

1. Ak. Rexhep Ismajli,
2. Dr. Zejnullah Rrahmani,
3. Dr. Jahja Draçolli,
4. Dr. Dukagjin Popovci,
5. Dr. Fetah Podvorica,
6. Dr. Skënder Kaçiu,
7. Dr. Zejnullah Gruda,
8. Dr. Nexhmi Rexha,
9. Dr. Isuf Kraniqi,
10. Dr. Xhevat Perjuci,
11. Dr. Abdyl Krasniqi,
12. Dr. Suzana Mangjuka,
13. Ak. Rexhep Ferri,
14. Dr. Radivoje Mançiq, dhe
15. Mr. Husnija Bibuljica.

## **SHTOJCA 2. Emrat e anëtarëve të organeve udhëheqëse të Ndërmarrjeve Publike.**

### **Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës**

Bahri Nuredini  
Bekim Jashari  
Besnik Krasniqi  
Bislim Zogaj  
Fejzullah Krasniqi  
Hanefi Muharremi  
Naser Canolli  
Shkëlzen Halili  
Valon Grabovci  
Xhyldane Kijmari

### **Kompania R. Ujësellsit Prishtina**

Adem Duriqi  
Bajram Jashari  
Ejup Hashani  
Gjelosh Gojani  
Gjelosh Vataj  
Hidajete Mustafa-Sadiku  
Kujtim Xhelili  
Mentor Balaj  
Selatin Retkoceri

## **Kompania R. e Mbeturinave Çabрати**

Avdullah Babalija

Ekrem Pylla

Fuat Pallaska

Gazmend Tuzi

Gëzim Qarri

Hajrullah Dauti

Illirjana Efendija

Valbone Shehu

## **Kompania Regjionale e Mbeturinave “Pastrimi”**

Ajshe Simnica

Feim Salihu

Fitim Selimi

Fitim Vokrri

Hamdi Jaha

Kemail Hashani

Sabri Kadriu

Sadije Fetaj

Shuajb Mehmeti

Tomor Çela

## **Kompania R. e Mbeturinave Uniteti**

Eset Shaqiri

Fehmi Mehmeti

Ilaz Halili

Nehat Berani

Qefsere Peci

Skender Tahiraj

Ukshin Rreci

## **Kompania R. e Ujësellsit Hidromorava**

Avdyl Hasani

Azem Mujku

Elhame Shefkiu-Ramadani

Myrvete Hoti

Samet Idrizi

Seniha Hajrullahu

Xhelal Selmani

## **Kompania R. e Ujësjetit Radoniqi**

Artan Nimani

Hajdar Grezda

Ismet Ahmeti

Jahja Kadrija

Kadrush Shala

Kastriot Zhaveli

Leonard Shehu

Mehmet Shehu

Saranda Vehapi

## **Kompania e Ujitjes Radoniqi-Dugagjini**

Avdullah Kryeziu

Cana Delija

Emrullah Zeneli

Fidan Qufaj

Ismet Neziraj

Luljeta Morina

## Korporata Elektroenergjetike e Kosovës

Agim Nika

Arben Gjuka

Bekim Jakupi

Burim Leci

Driton Pruthi

Enver Muli

Fadil Çitaku

Faton Deda

Flamur Keqa

Izet Ibrahim

Mentor Hyseni

Mujë Rugova

Pranvera Dobruna-Kryeziu

Salih Bytyqi

Ymer Dragusha

## **NP Infrakos SHA**

Agron Thaçi

Amir Morina

Avni Murati

Bajram Mustafa

Fadil Krasniqi

Faton Gjyshinca

Halil Kika

Halim Peci

Hysen Fazliu

Izet Mijalica

Lutfi Jusufi

Naser Hoti

Naxhie Sadiku

Nexhmi Rama

Osman Kozmaqi

Valdrin Kasumaj

Xhevat Ramosaj

Zymer Zekaj

## **NP Trainkos SHA**

Agron Thaqi

Besarta Rrahmani

Besfort Metaj

Betim Gjoshi

Burim Zekaj

Fadil Krasniqi

Halil Kika

Hasan Ibraj

Heset Cakolli

Hysen Fazliu

Isa Derguti

Labinot Halilaj

Liridon Restelica

Remzi Jashari

Shkumbin Hyseni

Zair Imeri

## **Ndërmarrja Publike Banesore Prishtinë**

Arjeta Qehaja-Shkodra

Hasan Fejzullahu

Ilir Azemi

Rexhep Zeqiri

Sabedin Haxhiu

Sevdie Alshiqi

Valbona Hamiti

Visar Hoti



## **Ngrohtorja e Qytetit**

Astrit Dema

Diana Zuka

Fatos Koshi

Flamur Babalija

Nexhmedin Doli

Nurije Haxhikadrija

Shqipe Byci

## **Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut**

Abdulsatar Ibrahim

Besim Gërxhaliu

Fadil Ismaili

Ilir Shala

Jusuf Imeri

Naim Bejtullahu

Nazmi Mikollovci

Nebih Haziri

Ramadan Paçarada

Resmije Ahma

Sabri Musiqi

Shaqir Rexhepi

Skender Gjonbalaj

## Radio Televizioni i Kosovës

Aleksandar Janicevic

Anamari Repic

Arben Fetoshi

Azem Bujupi

Bekim Hasani

Bujar Spahija

Elvana Prekazi

Fadil Bajraktari

Faton Mehmetaj

Ismet Bexheti

Ivan Veljković

Kriste Gojani

Lindita Tahiri

Majlinda Hajrullahu

Mentor Shala

Mufail Limani

Naime Beqiraj

Rahman Paçarizi

Zekrija Dushi

## **K.R.U.K. Bifurkacioni**

Afrim Spahiu

Asllan Shabani

Emin Plakaj

Faton Frangu

Skender Ismaili

Ylber Topalli

## **Kompania R. Hidrogjeni Jugor**

Besim Baraliu

Bujar Hasani

Drita Grazhda

Galip Hoda

Liman Gashi

Rexhã« Ukaj

Sait Ukaj

Xhihanmert Kaqamaku

Ymridin Sylejmani

## **Kompania R. e Mbeturinave Ambienti**

Agron Tigani

Aurora Sinanaj-Dinaj

Demë Abazi

Gani Luta

Haxhi Mehmeti

Nexhat Abdullahi

Sadik Bujupi

## **Kompania R. e Mbeturinave Ekorexhioni**

Avni Cena

Bashkim Krasniqi

Hasan Hasani

Lulzim Omaj

Muharrem Morina

Nehat Basha

Perparim Krasniqi

Remzi Kololli

Sadik Paqarizi

Shaban Veseli

Shkodran Veseli

Tafil Krasniqi

## **Kompania R. e Mbeturina ve Pastërtia**

Ajshe Simnica

Arsim Hamiti

Besim Hoxha

Fatmir Zymeri

Ferid Bilalli

Gazmend Bytyçi

Hajrie Nebihi

Rafiz Shabiu

Skënder Ferizi

Skender Hyseni

Zylfi Koxha

## **Kompania R. e Ujësjetit Hidrodrini**

Agron Tigani

Gjelosh Gojani

Naim Ferati

Ragip Shabotic

Rasim Maloku

Rexhë Abazi

Shkelzen Hyseni

## **Kompania R. e Ujësellsit Mitrovica**

Faruk Hajrizi

Fehmi Kajtazi

Granit Shala

Haki Maxhuni

Muhamet Salihu

Nystret Gerxhaliu

Remzi Sylejmani

Sami Miftari

## **Kompania e Ujitjes Drini i Bardhë**

Ali Sefaj

Beqir MetajF

Fadil Kabashi

Leonora Bajraktari

Milazim Shatri

Mjellma Vokshi

Shkodran Gaxherri

## **Kompania për Menaxhimin e Deponive**

Abdullah Haxhiu

Asllan Vitaku

Bajram Limani

Eset Rama

Faruk Blakçori

Isak Rakovica

Makfire Osmani

Naim Ferati

Sylejman Kerolli

## **NPH Ibër Lepenci**

Arbëror Prekazi

Bahri Hyseni

Bajram Jashari

Bajram Mustafa

Demë Abazi

Faton Gjyshinca

Gjelosh Vataj

Hajdar Beqa

Ilmi Ahmeti

Lutfi Jusufi

Naxhie Sadiku

Osman Kozmaqi

Sheremet Smakolli

## **Ndërmarrja Publike Hortikultura**

Afrim Shala

Agron Dobratiqi

Arton Shabani

Isak Rakovica

Kimete Sahiti-Pacolli

Myzaferre Uka

Ramadan Cakiqi

Salih Gashi

## **Ngrohtorja e Qytetit Termokosi**

Arsim Janova

Asdren Osaj

Astrit Shyti

Fadil Berisha

Imer Hamiti

Liman Kastrati

Nadire Vitija

Sherafedin Mumxhiu



## **Posta e Kosovës Sh.A**

Aziz Pacolli  
Bardhyl Sejdiu  
Behxhet Maliqi  
Besnik Jani  
Blerim Krasniqi  
Branislav Nikolic  
Burim Geci  
Demir Lima  
Ejup Qerimi  
Elmaze Pireva  
Fatmir Gjonbalaj  
Faton Thaçi  
Gani Sylaj  
Gazmend Isufi  
Gëzim Pajaziti  
Halit Isufi  
Hasim Krasniqi  
Mehdi Latifaj  
Menduh Abazi  
Nuhi Ahmeti

Nuredin Krasniqi  
Olivera Anti  
Qamil Buzhala  
Rexhë Gjonbalaj  
Sahit Surdulli  
Sebahedin Ramoxhiku  
Sejdi Hoxha  
Shefqet Avdija  
Valon Zhuniqi  
Xhevdet Smakiqi  
Xhylyjete Izmaku  
Zair Imeri

## **KRU Hidroregjioni Jugor Sh.A Prizren**

Naser Bajraktari

## **Lista e të intervistuarve :**

Sami Kurteshi – Avokati i Popullit

Visar Ymeri – Deputet, shef i grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje

Ali Sadriu – Deputetë, Kryetar i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Avni Zogiani – Drejtor Ekzekutiv i Organizatës “QOHU”

Agron Demi – Drejtor Ekzekutiv i Organizatës “GAP”

Pranvera Dobruna – Anëtare e Bordit të KEK-ut

Bajram Ajeti - Kryetar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Intervistë personale

Agron Krasniqi - Zëvendësdrejtor i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës. Intervistë personale.

## **Bibliografia**

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

<http://www.kushtetutakosoves.info/>

Komentar – Kushtetuta e Republikës së Kosovës, botimi I, f.672. Autor Enver Hasani, Ivan Cukalovic. 2013

Raporti i Progresit të Komisionint Evropian për Kosovën 2013

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2013/package/ks\\_rapport\\_2013.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/ks_rapport_2013.pdf)

Vendimi i Kuvendit <http://kpm-ks.org/materiale/dokument/1388153194.0154.pdf>

Doracak - Funkzioni Mbikëqyrës i Komisioneve parlamentare, f. 41

Gjendja e institucioneve të pavarura në Kosovë – botuar nga OSBE në Kosovë, korrik 2012, f.4.

<http://www.osce.org/sq/kosovo/92052?doënload=true>

ZAP, Raporti vjetor i Auditimit 2012,

[http://oag-rks.org/repository/docs/RVA\\_2012\\_Shqip\\_923921.pdf](http://oag-rks.org/repository/docs/RVA_2012_Shqip_923921.pdf)

### **Ligjet:**

Ligjit për Aviacioni Civil

[http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L051\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L051_al.pdf)

Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë

[http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com\\_content&task=view&id=141&Itemid=56](http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=141&Itemid=56)

Ligji nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. <http://kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-192-alb.pdf>

Ligji nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit, 5 shkurt, 2010.

[http://akk-ks.org/repository/docs/Ligji\\_per\\_Agjencine\\_kunder\\_Korrupsionit\\_nr\\_03\\_L\\_159.pdf](http://akk-ks.org/repository/docs/Ligji_per_Agjencine_kunder_Korrupsionit_nr_03_L_159.pdf)

Ligji nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, 27 gusht, 2010.

[http://www.kosovomining.org/kosovoëeb/al/downloads/legislation/basicContentParagraphs/00/document/Ligji%20per%20Minierat%20dhe%20Mineralet%20\(shqip\).pdf](http://www.kosovomining.org/kosovoëeb/al/downloads/legislation/basicContentParagraphs/00/document/Ligji%20per%20Minierat%20dhe%20Mineralet%20(shqip).pdf)

Ligji për Ndërmarrjet Publike, Nr. 03/L-087, Neni 17.

<http://gazetazyrtare.rksgov.net/Documents/Microsoft%20Word%20%20ligji%20per%20ndermarrjet%20publike%2087%20lekturuar.%2024.06.2008.pdf>



Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS).